



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA ISTOG  
OPŠTINA ISTOG  
MUNICIPALITY OF ISTOG



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT  
REPUBLIKA KOSOVA OPŠTINA ISTOK  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE

Udhëzimi

000-  
Br: 15-033 Data: 06.01.2023  
Datum

ISTOG-ISTOK

# Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027

Dhjetor 2022, Istog

|     |                                                                                                        |    |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1   | Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave.....                                          | 8  |
| 1.1 | Qëllimi dhe fushëveprimi i planit.....                                                                 | 8  |
| 1.2 | Baza ligjore dhe institucionale për hartimin e planit .....                                            | 9  |
| 1.3 | Konteksti lokal .....                                                                                  | 12 |
| 2   | Gjendja ekzistuese e menaxhimit të beturinave .....                                                    | 24 |
| 2.1 | Të dhënat për mbeturinat komunale .....                                                                | 24 |
| 2.2 | Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave .....                                           | 24 |
| 2.3 | Rishikimi i implementimit të planit .....                                                              | 28 |
| 2.3 | Performance e shërbimit .....                                                                          | 31 |
| 2.4 | Performanca financiare e MM .....                                                                      | 32 |
| 2.5 | Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave .....                                   | 33 |
| 2.7 | Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave .....                                                      | 34 |
| 3   | Objektivat e MM dhe plani operacional.....                                                             | 35 |
| 3.1 | Vizioni i MM.....                                                                                      | 35 |
| 3.2 | Objektivat dhe caqet e MM.....                                                                         | 35 |
| 3.3 | Objektivi 1: Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave .....                                 | 35 |
| 3.4 | Objektivi 2: Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave .....                                             | 39 |
| 3.5 | Objektivi nr. 3: Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme të MM<br>47                  |    |
| 3.6 | Objektivi nr. 4: Trajtimi dhe deponimi i sigurt i mbeturinave si mjeti i fundit.....                   | 50 |
| 3.7 | Objektivi 5: Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për menaxhimin e<br>mbeturinave ..... | 51 |
| 4   | Plani i MM në kushte emergjente.....                                                                   | 52 |
| 5   | Plani financiar, veprimit dhe monitorimit .....                                                        | 53 |

#### Lista e Shkurtesave

|       |                                                                   |
|-------|-------------------------------------------------------------------|
| AMMK  | Agjencioni i Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës                     |
| ASK   | Agjencioni i Statistikave të Kosovës                              |
| BE    | Bashkimi Evropian                                                 |
| BMZ   | Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik |
| CEDE  | Qendra për Edukim dhe Zhvillim të Mjedisit                        |
| DRS   | Sistemi i kthimit të depozitës                                    |
| ELV   | Automobila mbeturinë                                              |
| EPR   | Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit                              |
| GIZ   | Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik |
| QeK   | Qeveria e Kosovës                                                 |
| ITMB  | Impijanti për trajtimin mekanik biologjik                         |
| IWMS  | Sistemi i menaxhimit të integruar të mbeturinave                  |
| JICA  | Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar                    |
| KfW   | Kreditanstalt für Wiederaufbau                                    |
| KIWER | Instituti i Kosovës për hulumtim të ujit dhe mjedisit             |
| KLMC  | Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës                     |
| KRM   | Kompania Regjionale e Mbeturinave                                 |
| MESPI | Ministria e mjedisit planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës   |
| MND   | Mbeturina nga ndërtim demolimi                                    |
| MPEE  | Mbeturina nga pajisje elektrike dhe elektronike                   |
| MRF   | Qendra e rikuperimit të materialit                                |
| OECD  | Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik                  |
| PKMM  | Plani komunal për menaxhim të mbeturinave                         |
| PPP   | Partneriteti publik privat                                        |
| PZP   | Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit                              |
| SIMM  | Strategjia e integruar e menaxhimit të mbeturinave                |
| WFD   | Direktiva kornizë e mbeturinave                                   |

## Komuna e Istogut

### Lista e tabelave

|           |                                                                                                     |
|-----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Tabela 1  | Të dhënat mbi popullatën                                                                            |
| Tabela 2  | Migrimi ndërkombëtar dhe kombëtar për vitin 2021 në Komunën e Istogut                               |
| Tabela 3  | Numri ndërmarrje të regulltë në komunën e Istogut                                                   |
| Tabela 4  | Rrezja shërbyese optimale në vijen ajrore (m)                                                       |
| Tabela 5  | Sasia e mbeturinave të grumbulluara dhe deponuara 2021 nga ndërmarrja "Ambienti"                    |
| Tabela 6  | Kompozicioni i mbeturinave bazuar në analizën e kompozicionit të mbeturinave 2020-2021(rasti Pejë). |
| Tabela 7  | Mbeturinat e reciklueshme të grumbulluara nga operatorët                                            |
| Tabela 8  | Operatorët për menaxhimin e mbeturinave nën përgjegjësin komunale                                   |
| Tabela 9  | Operatorët tjerë të mbeturinave që operojnë në territorin e komunës                                 |
| Tabela 10 | Mbulimi me shërbim në territorin e komunës                                                          |
| Tabela 11 | Mbulimi i shërbimit për EF sipas vendbanimeve                                                       |
| Tabela 12 | Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit                                                     |
| Tabela 13 | Pajisjet për hudhjen dhe grumbullimin e mbeturinave                                                 |
| Tabela 14 | Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave                                                |
| Tabela 15 | Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual                                                  |
| Tabela 16 | Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM                                                            |
| Tabela 17 | Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave                                           |
| Tabela 18 | Shpenzimet e shërbimit të MM                                                                        |
| Tabela 19 | Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM                                                 |
| Tabela 20 | Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit                                                        |
| Tabela 21 | Lista e propozuar e objektivave të planit                                                           |
| Tabela 22 | Korniza strategjike e Objektivit 1                                                                  |
| Tabela 23 | Shpërndarja e komposterëve për shtëpi rezidenciale dhe restorante "zero mbeturina":                 |
| Tabela 24 | Korniza strategjike e Objektivit 2                                                                  |
| Tabela 25 | Parashikimet demografike të popullatës                                                              |
| Tabela 26 | Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave                                                             |
| Tabela 27 | Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit                                         |
| Tabela 28 | Caqet e riciklimit                                                                                  |
| Tabela 29 | Orari i ndarjes së mbeturinave në burim                                                             |
| Tabela 30 | Korniza strategjike e objektivit 3                                                                  |
| Tabela 31 | Strategjia e zgjerimit me shërbim                                                                   |
| Tabela 32 | Efikasiteti i stafit                                                                                |
| Tabela 33 | Korniza strategjike e objektivit 4                                                                  |

## Komuna e Istogut

|           |                                                                                                                     |
|-----------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Tabela 34 | Korniza strategjike e objektivit 5                                                                                  |
| Tabela 35 | Plani financiar, veprimet dhe monitorimet - Objektivi 1 „Parandalimi dhe reduktimi”                                 |
| Tabela 36 | Plani financiar, veprimet dhe monitorimet - Objektivi 2 „Ripërdorimi dhe riciklimi                                  |
| Tabela 37 | Plani financiar, veprimet dhe monitorimet - Objektivi 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme   |
| Tabela 38 | Plani financiar, veprimet dhe monitorimet - Objektivi 4 „Deponimi i sigurtë si mjet i fundit                        |
| Tabela 39 | Plani financiar, veprimet dhe monitorimet - Objektivi 5 „Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM |

**Fjala e kryetarit**

Commented [AN1]: Te plotesohet nga Zyra e kryetarit

Kam kënaqësin si kryetar të shpalos para qytetarëve të komunës së Istogut këtë Plan Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, i cili është dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve në fushën e menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal. Qëllimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Istogut 2023-2027, është që të identifikoj dhe ofrojë zgjidhje për problemet prioritare për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Istogut, duke synuar në një menaxhim efektiv të tyre, duke i vendosur ato në agjendën e institucioneve përgjegjëse dhe duke marrë në konsideratë në mënyrë të vazhdueshme opinionin e publikut. Objektivat specifike të PKMM 2023-2027, janë: të bëjë vlerësimin e gjendjes ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave dhe ndikimeve në mjedis nga sektorët e ndryshëm zhvillimor, të identifikoj dhe përcaktoj problemet kryesore në menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Istogut, të identifikoj dhe përcaktoj prioritetet kryesore që do të adresohen në kuadër të PKMM- së për periudhën 5 vjeçare, të planifikohen dhe përcaktohen afatet, aktivitetet që do të ndërmerren për zbatim në adresimin e prioritetëve të identifikuar. Vizioni i këtij plani, synon për qytetin e Istogut një mjedis të pastër, zhvillim ekonomik të qëndrueshëm me prioritet zhvillimin e bujqësisë, si dhe promovim të trashëgimisë kulturore dhe turizmit.

Ky Plan është në harmoni edhe me dokumentet tjera të Komunës së Istogut. Janë marrë për bazë edhe kërkesat e Strategjisë për menaxhim të integruar të mbeturinave 2021-2030 në Republikën e Kosovës e zhvilluar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në përputhje me Ligjin për Mbeturina, kjo strategji paraqet bazën për hartimin e PKMM në Komunë e Istogut, orientimet strategjike dhe kornizën e veprimeve për menaxhimin e mbeturinave.

Prioritetet kryesore për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Istogut, mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave prej të gjitha vendabimeve të komunës së Istogut, rritjen e cilësisë së shërbimit, ndarjen dhe klasifikimin e mbeturinave që në burim, plotësimin e bazës rregullative, programore dhe institucionale për menaxhimin e mbeturinave për përmirësimin e sistemit për grumbullimin e mbeturinave, eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave, rritja e nivelit dhe mundësive për ndarje dhe riciklimin e mbeturinave.

Në emër të qytetarëve të Komunës së Istogut, falënderoj kontribuesit gjatë hartimit të PKMM, 2022-2027 në komunën e Istogut, Grupin punues në nivel komunal për hartimin e PKMM-së, GIZ, KIWER, CEDE dhe ekipin mbështetës teknik duke ju ftuar të gjithëve që këtë dokument strategjik ta konceptojmë si një vlerë të përbashkët, e cila do të rrisë cilësinë e jetës për të gjithë.

Përzemërsisht,

Kryetari i Komunës

## 1 Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

### 1.1 Qëllimi dhe fushëveprimi i planit

Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta (PKMMN) në Komunën e Istogut është dokument planifikimi që e mundëson zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Planin e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave në nivel lokal, duke i kontribuar zbatimin të politikave dhe përmbushjes së objektivave kombëtare.

PKMM-ja paraqet dokumentin bazë me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës. Objektivi i PKMM është që të analizon situatën aktuale të menaxhimit të mbeturinave në tërë territorin e komunës (organizimi, administrimi, rregulloret, financat, operimi dhe menaxhimi), të identifikoj çështjet dhe mangësitë, të vlerësoj pikat e forta dhe të dobëta, të propozoj rekomandime për përmirësime të gjendjes dhe përcaktoj vizionin, qëllimet dhe objektivat e reja (afatshkurtra, afatmesme), si dhe të hartoj një Plan Veprimi ku përcaktohen afatet kohore, kostot, autoritetet përgjegjëse si edhe indikatorët respektivë të suksesit për qëllime monitorimi.

Qëllimi i PKMM është ofrimi i kornizës strategjike për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave për periudhën pesëvjeqare për territorin e administruar nga Komunës së Istogut në pajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe kornizën planifikuese strategjike. PKMM është i hartuar në mënyrën që merr për bazë parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave si në vijim:

PKMM trajton vetëm mbeturinat e ngurta, dhe nuk përfshihen mbeturinat e veçanta të cilat nuk janë kompetencë e komunës. Por do të përfshij raportimin e këtyre mbeturinave te institucionet përgjegjëse siç është AMMK/MMPHI.

PKMM ka si qëllim që të mundësojë dhe të sigurojë:

- Përputhshmëri me Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave (SRKMM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave dhe arritjen e objektivave kombëtare të paracaktuara në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
- Identifikimin e prioritetëve në sektorin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- Opsionet më të mira për menaxhimin e mbeturinave: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me objektivat kombëtare.
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për

## Komuna e Istogut

përmirësimin e elementëve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbeturinat në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e menaxhimit të tyre.

- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave;
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbeturina sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

PKMM do të shërbej si kornizë planifikuese dhe e veprimit për implementimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, hartimin e buxheteve, përpilimin e planeve investuese, si dhe tërheqjen e asistencës së jashtme.

**Vizioni** - Komuna e Istogut duke u bazuar në synimin e përgjithshëm do të sigurojë që shërbimet për rreth menaxhimit të mbeturinave të përfshijnë mbulueshmërinë e 100 % të territorit të Komunës.

**Misioni**- Komuna e Istogut do të angazhohet maksimalisht për zgjerimin e Shërbimit të Mbledhjes së Mbeturinave dhe për ngritjen e cilësisë së shërbimit. Kurse në një afat sa më shkurtër, komuna e Istogut planifikon që shërbimin e mbledhjes së mbeturinave të bëjë në formë më modern respektivisht përmes mbledhjes së diferencuar për të inkurajuar riciklimin, reduktimin e mbeturinave, ndarja në burim dhe kompostimin.

**Masat e Shërbimit të Grumbullimit të Mbeturinave:**

- **Masa e Parë** - Ngritja e Cilësisë së Shërbimit në mënyrë të qëndrueshme dhe respektimi i standardit nga të gjithë ata të cilëve u ofrohet shërbimit.
- **Masa e dytë** - Rritja e Mbulueshmërisë me Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave dhe përmirësimi i situatës financiare që lidhet me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbeturinave.
- **Masa e Tretë** - Krijimi i strukturave organizative;
- **Masa e Katërtë**- Vlerësimi i gjendjes ekzistuese;
- **Masa e Pestë**- Planifikimi operacional i menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave;
- **Masa e Gjashtë**- Planifikimi financiar për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave;
- **Masa e Shtatë**-

Konsultimet për zbatueshmërinë e planit me përfaqësuesit kryesorë të komunës.

### 1.2 Baza ligjore dhe institucionale për hartimin e planit

#### 1.2.1 Baza ligjore për hartimin e planit

Baza themelor legjislativë për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë është Ligji 2011-04 L 060 për Mbeturinën i cili rregullon aspektet specifike të menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe llojeve tjera të mbeturinave. Ligji në fjalë ndërmjet tjerash ofron parimet bazë mbi menaxhimin e mbeturinave përfshi klasifikimin e mbeturinave si dhe rolet e

përgjegjësi të aktorëve kyq në menaxhimin e tyre, si aspektet e operimit, dhe licencimit të operatorëve.

Në mënyrë specifike **Ligji i Mbeturinave** përmes Nenit 15 i përcakton kompetencat e komunave sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Komunitat sipas këtij Neni janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e Planeve Komunale të Menaxhimit të Mbeturinave, krijimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, përzgjedhjes së operatorëve të licencuar si dhe përcaktimit të tarifave dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve. Ligji i mbeturinave është hartuar në masë të konsiderueshme me direktivat përkatëse të KE që e rregullojnë lëminë e menaxhimit të mbeturinave komunale dhe rrjedhave tjera të mbeturinave.

Korniza Ligjore përmban edhe një numër të konsideruar të ligjeve tjera sektoriale të cilat në mënyrë indirekte rregullojnë menaxhimin e mbeturinave. Këto Ligje përfshijnë: Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, etj.

Neni 17 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përcakton menaxhimin e mbeturinave si kompetencë të komunave përfshi edhe aspektet e menaxhimit operativ dhe financiar të shërbimit dhe buxhetimit.

Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ndërmjet tjerash rregullon aspektet relevante të pronësisë së ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave, udhëheqjen kooperative, transparencën financiare, dhe formimin e ndërmarrjeve komunale.

Baza ligjore për menaxhimin e mbeturinave në nivelin lokal të Komuna e Istogut përfshinë:

- Rregulloren Komunale për Mbrojtjen e Mjedisit(Nr.3/2006;
- Rregulloren Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Istogut;
- Rregulloren për Leje mjedisore etj.

Dokumentat tjera planifikuese-ligjore në lëmin e menaxhimit të mbeturinave janë edhe:

- Strategjia (2021-2030) dhe Plani i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë- dokument strategjik që synohet të arrij zhvillimin e integruar dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave dhe të ndikoj në ruajtjen e shëndetit publik, zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Dokumenti synon të trajtojë të metat dhe kufizimet aktuale në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke i përcaktuar dhe realizuar objektivat strategjike.

Dokumente strategjike në nivel lokal që rregullojnë dhe trajtonë aspektet e menaxhimit të mbeturinave:

- **Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Istogut 208-2026** - siguronë një kornizë të zhvillimit afatgjatë të Komunës, duke përcaktuar qëllimet afatgjate të zhvillimit dhe duke identifikuar prioritetet strategjike me të cilat sigurojnë:
  - Një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, me më shumë vende të reja të punës
  - Një zhvillim të përparuar social dhe mundësi të barabarta të qasjes për të gjithë

- Mbrojtje dhe zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit – resurseve natyrore dhe kulturore
- Një infrastrukturë të integruar dhe shërbime efikase për qytetarët.<sup>1</sup>

- **Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2012/2017-** Dokument planifikues - strategjik, që adresoj zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal për periudhën 5 vjecare.

#### 1.2.2 Korniza institucionale për menaxhimin e mbeturinave

Rolet dhe përgjegjësitë e akterëve kyq sa i përket menaxhimit të mbeturinave janë të sanksionuara me Ligjin mbi Mbeturina dhe aktet tjera relevante ligjore dhe nënligjore. Autoritet kryesore të menaxhimit të mbeturinave janë Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunitet e Kosovës.

Sipas Ligjit të Mbeturinave Ministria administron me mbeturinat e rrezikshme, mbeturinat toksike, mbeturinat likuide, industriale dhe të ngjashme. Komunitet nga ana tjetër menaxhojnë me mbeturinat komunale, mbeturinat inerte dhe nga demolimet, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat tjera jo të rrezikshme.

Neni 14 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e MMPH dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i). Hartimin e ligjeve, politikave strategjiksë për menaxhimin e mbeturinave; (ii) zbatimin e strategjisë dhe masterplanit; (iii) dhënjën e licencave për operatorët; (iv) dhe krijimin e bazës së shënimeve dhe sistemit informativ për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 15 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e Komunitet dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i) krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave; (ii) hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave; (iii) përzgjedhjen e personave të licencuar për menaxhimin e mbeturinave; dhe (iv) caktimin e tarifave të mbeturinave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve.

Autoritet tjera për menaxhimin e mbeturinave janë:

- **Ministria e Zhvillimit Ekonomik** - Menaxhimi i Ndërmarrjeve Publike në Nivel Qëndror përfshi Komunitet për Menaxhimin e Deponive të Kosovës; caktimi i tarifave për deponimin e mbeturinave
- **Ministria e Shëndetësisë** - Menaxhimin e Mbeturinave dhe Produkteve Medicinale
- **Ministria e Punëve të Brendshme** - Bënë koordinimin në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore e të tjera dhe sipas nevojës cakton anëtarët pjesëmarrës në komisionin për vlerësimin e dëmeve eventuale nga mbeturinat.
- **Agjencioni i Veterinës dhe Ushqimit** - është përgjegjës për rregullimin e aspekteve të menaxhimit me mbeturinat me prejardhje shtazore;
- **Dogana e Republikës së Kosovës** - kryen kontrollin, evidentimin dhe mbikëqyrjen e importit, eksportit dhe kalimit transit të mbeturinave

<sup>1</sup> Plani zhvillimor Komunal i Komunitet së Istogut 2018-2026

## Komuna e Istogut

- **Policia e Republikës së Kosovës** - bashkëpunon me agjencionet dhe organizatat e vendeve tjera për identifikimin, luftimin dhe parandalimin e veprimeve të ndaluara dhe keqpërdorimit të mbeturinave.

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në menaxhimin e mbeturinave janë paraqitur si në vijim:

- **Drejtoria e Shërbimeve Publike (DSHP)** është përgjegjëse për menaxhimin e të mbeturinave komunale, monitorimin e punëve të kompanive të angazhuara për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe hapësirave tjera komunale. DSHP është përgjegjëse për caktimin e tarifave të shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale nga ndërmarrjet për administrimin e mbeturinave si dhe propozon taksat, tarifat dhe ngarkesave tjera komunale si dhe inkasimin e tyre sipas Rregullores Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha.
- **Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis** është përgjegjëse për planifikimin e zhvillimit hapësinor dhe urbanistik të Komunës,, po ashtu siguron mbështetje në zhvillimin e projekteve në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit.
- **Drejtoria për Punë Inspektuese** e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregulloreve komunale në lëmin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit, Bujqësisë dhe Pylltarisë.
- **Kompania Publike Lokale për Mbeturina KRM "Ambienti"** - Komuna ka themeluar KRM "Ambienti", dega në Istog. KRM "Ambienti" ofron shërbim sipas statutit të saj duke ushtruar kompetenca ekzekutive.

**Commented [AN2]:** Te regullohet sipas forms se operomit, - Kompania nuk esht themeluar nga komuna por esht njesi e KRM Ambienti ne Pejë

### 1.3 Konteksti lokal

#### 1.3.1 Pozita gjeografike

Komuna e Istogut shtrihet në pjesën veriore të rrafshit të Dukagjinit. Territori i Komunës së Istogut, në veri-perëndim kufizohet me Malin e Zi dhe Serbinë, në veri-lindje me Komunën e Zubin Potokut, në lindje me Komunën e Skenderajt, në jug me Komunën e Klinës dhe në jug-perëndim me Komunën e Pejës. Ka sipërfaqe prej 453.84 km<sup>2</sup>. Qendër komunale është qyteti Istog dhe nën administrim ka 50 vendbanime.



Fig 1: Pozita gjeografike e komunës së Istogut në Kosovë

Istogu ka një pozitë të përshtatshme gjeografike, e hapur në të gjitha anët, më përjashtim të pjesës veriore e cila është e rrethuar më male të larta më lartësi mbidetare përtej 2.000 metrave. Më një infrastrukturë të mirë rrugore, që i mundëson komunikim të mirë me trevat tjera të Kosovës. Përveç Istogut, si qendër komunale, në kuadër të komunës përfshihen edhe këto vendbanime: Banjë, Banjicë, Belicë, Bellopojë, Carallukë, Cërkohez, Cerrcë, Dobrushë, Dragolec, Drejë, Dubovë e Vogël, Dubravë, Gjurakoc, Istog, Istog i Poshtëm, Kaliqan, Kashicë, Kërrninë, Kosh, Kovragë, Llugë, Llukac i Begut, Llukac i Thatë, Lubovë, Lubozhdë, Mojstir, Muzhevinë, Orrobërdë, Osojan, Polanë, Prekallë, Prigodë, Rakosh, Serbobran, Shalinovicë, Shushicë, Sinajë, Staradran, Studenicë, Suhogërlë, Tomoc, Trubuhoc, Tuçep, Uçë, Veriq, Veriq i Ri, Vrellë, Zabllaq, Zallq, dhe Zhakovë.

*Territori i Komunës së Istogu* ka një ndarje gjeografike në tri zona si më poshtë:

**Zona e Fushës** që mbulon afërsisht 44% të territorit, ku shtrihen numri më i madh i vendbanimeve, e banuar me rreth 62% të numrit të tërësishëm të banorëve të komunës së Istogut. Kjo pjesë e Komunës është kryesisht rrafshinore me lartësi mbidetare 400 – 500 m. Në kuadër të kësaj zone shtrihen dy subqendrat – Gurakoci dhe Banja.

**Zona e emëruar “Rrëza”** përfshinë vendbanime që shtrihen ndërmjet zonës rrafshinore “Fushës” dhe zonës kodrinore “Bjeshkës” si dhe paraqet “kufirin” ndërmjet rrafshit dhe kodrës. Ka një shtrirje vijore, me lartësi mbidetare prej 500 - 650 m. Kjo zonë përfshinë 17% të sipërfaqes së tërësishme të komunës. Përgjatë tërë territorit kjo zonë përshkohet nga rruga regjionale Mitrovicë-Pejë-Mali i Zi.

Zona "Bjeshka" përfshinë zonën veriore të komunës dhe përbëhet nga malet dhe pjesërisht nga toka bujqësore, livadhet dhe kullosat. Kjo zonë mbulon afërsisht 39% të sipërfaqes së tërësishme të komunës ndërsa ka një dendësi shumë të ulët të popullsisë vetëm 4% e numrit të tërësishëm të banorëve të komunës.

#### Klima

Komuna e Istogut ka klimë të mesme kontinentale. Në klimë ndikojnë faktorë mikroklimatikë që japin disa specifika të vogla kësaj hapësire. Prej faktorëve mikroklimatikë më të rëndësishmit që ndikojnë në klimën e Istogut janë; lumenjtë, malet e thepisura nga Bjeshkët e Nemura.

Dallimi në hipsometri prej 650 m kuota më e ulët dhe ato të larta prej 2177 m paraqet diferencë të theksuar në metër që e shprehur në temperaturë dallimi është 7,3 0 C. Temperaturat në këtë komunë oscillojnë dhe kanë mjaft dallime mujore dhe sezonale.

Temperatura mesatare është 9,6 0 C, muaji me i ftohtë është janari me temperaturë mesatare -2,50 C, muaji më i ngrohtë është korriku dhe gushti me 20.10 C. Muaji më i ftohtë me temperaturë ekstreme është janari me -27,2 0 C, ndërsa muaji me temperaturë më të lartë është gushti me 37,00 C. Në periudhën vegetative paraqiten temperatura negative që nganjëherë sjellin dëme në bujqësi. Për jetën e përditshme ka rëndësi lagështia relative e ajrit që paraqet shkallën e ngopshmërisë së ajrit me avull të ujit. Varësisht nga temperatura e ajrit varet edhe lagështia relative e ajrit.

#### Sasia e të reshurave

Sasia vjetore e reshjeve është mbi 700 mm që është nën mesataren e Kosovës (790mm). Muaji më i lagësht është maji (77,5) ndërsa muaji më i thatë marsi me 42,3mm. Prej stinëve vjeshta është më e lagështa ndërsa vera është më e thatë me 147,9 mm. Nëse kalkulojmë sasinë e reshjeve me madhësinë e territorit të komunës së Istogut del se mesatarisht bien 432 mil m<sup>3</sup> ujë. Meqë territori i kësaj komune shtrihet në pjesë malore që kanë sasi të reshjeve më të lartë, atëherë sasia e reshjeve është më e madhe.

#### Erërat

Erërat fryjnë në drejtimin veriore, në jug perëndim dhe më pak verilindore. Shpejtësi me të madhe mesatare kanë erërat veriore dhe jugperëndimore.

Erërat me drejtimin e lëvizjes dhe shpejtësinë e tyre janë një ndër parametra e kushteve klimatike që për komunën e Istogut shkakton pasoja dhe dëme në rendimente bujqësore, objekteve përcjellëse për deponimin e rendimenteve të bujqësisë, demolimin e serave si dhe pullaze të objekteve të banueshme.

##### 1.3.2 Resurset natyrore

Komuna e Istogut ka resurse të larmishme natyrore. Në këto resurse përfshihen Bjeshkët e Nemura, malet, burimet ujore nga burimet kastike, peisazhe etj. Komuna e Istogut ka rrjet mjaft të zhvilluar hidrografik, gjegjësisht ka numër mjaft të madh të lumenjve (përroskave) që kalojnë në territorin e saj. Lumenjtë e vegjël janë lumenj me tipare karakteristike për

## Komuna e Istogut

përroskat malore, që do të thotë se janë lumenj të vegjël, me oscilime shumë të mëdha të sasisë së ujit gjatë vitit. Lumenjtë kryesor në komunën e Istogut janë: lumi i Istogut, lumi i Vrellës dhe Drini i Bardhë, ndërsa rrjedha tjera ujore me rëndësi janë edhe: Shushica, Përroi i keq, Çaushti, Gujavçi, Bllagaça dhe lumi i Renovcit. Lumi i Istogut është arteria kryesore hidrografike. Ky lum e ka burimin e vet nga ujërat nëntokësore të Moknës. Istogu është një ndër degët e majta të lumit më të madh në Kosovë, Drinit të Bardhë. Sipërfaqja e pellgut të Istogut është  $F=434.7 \text{ km}^2$ , kurse gjatësia e lumit është  $L=14.0 \text{ km}$ . Lumi Istog kalon nëpër qytetin e Istogut.

Banja, e cila gjendet 15 km në pjesën perëndimore të Istogut, është e njohur me burimet e ujërave të nxehta. Temperatura e ujit e burimeve të nxehta është  $46-48^\circ\text{C}$ , kurse sasia e përgjithshme e ujërave të tyre është  $17,5 \text{ l/sec}$ .

### Resurset minerare

Guri gëlqerorë është një resursë minerarë e cila mbizotëron në viset malore dhe bjeshkëve të Istogut. Një ashtu rëra dhe zhavorri vlersohet si një resursë natyrore e cila shfrytëzohet nga sektori i ndërtimit në mas të madhe. Këto resurse natyrore minerare vazhdimisht shfrytëzohen nga operatorët ekonomike të kësaj Komune. Në komunën e Istogut janë të regjistruara mbi 10 operator të cilat bëjnë shfrytëzimin e resurseve natyrore, minerare apo zhavorrin e lumenjeve<sup>2</sup>. Këta operator bëjnë eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror.

### Fondi pyjor

Pyjet janë pasuri në vete për komunën e Istogut. Ato mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të këtij territori. Sipas të dhënave të regjistrimit sipërfaqet pyjore janë  $19.220 \text{ ha}$ , prej tyre në sektorin shoqëror janë afro  $13.570 \text{ ha}$  apo  $68,8\%$ , ndërsa në sektorin privat  $5.650 \text{ ha}$  apo  $32,2\%$ . Nga sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve në Kosovë ( $490.000 \text{ ha}$ ), Istogu me sipërfaqe pyjore merr pjesë me  $3,92\%$ . Pyjet në Istog ndahen në pyje të larta dhe pyje të ulëta. Janë të pasura me drunjt me një mesatare prej  $90 \text{ m}^3/\text{ha}$ . Etati vjetor në pyjet e Istogut sillet prej  $4-5 \text{ m}^3$ . Fatkeqësisht, fondi pyjor është në zvogëlim e sipër nga niveli i lartë i prerjeve legale dhe ilegale, zjarret dhe mungesa e pyllëzimeve të reja. Pyjet e larta janë kryesisht të ruajtura, duke iu falënderuar mospërshtatshmërisë së terrenit në të cilin gjenden.

#### 1.3.3 Popullsia

Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, Komuna e Istogut ka 50 vendbanime me një numër total të popullsisë 39289 banorë.

Tabela. 1: Të dhënat mbi popullatën

| Regjistrimi ASK 2011 |                    | Vlerësimi ASK 2021 |                     |
|----------------------|--------------------|--------------------|---------------------|
| Numri i populates    | Numri i amvisërive | Numri i populates  | Ngritje / zbritje % |

<sup>2</sup> Raport-Gjendja mjedisore e lumenjve e shkaktuar nga shfrytëtimi i rërës dhe zhavorit

#### Komuna e Istogut

39289 17,682 41,397 5%

Migrimi nërkombëtar dhe kombëtar i popullatës së Komunës së Istogut është paraqitur në tabelën e mëposhtme. Siç shihet migrimi i popullatës në vendet e ndryshme të botës është me i lartë sesa ai kombëtar.

Tabela 2: Migrimi ndërkombëtar dhe kombëtar për vitin 2021 në Komunën e Istogut<sup>3</sup>

| Gjithësej<br>popullsia e<br>vlerësuar<br>2020 | Migrimi ndërkombëtar 2021 |          |                                            | Migrimi Kombëtar 2021 |          |                                   | Balanci i<br>përgjith-<br>shëm i<br>migrimit | Gjithësej<br>popullsia<br>dhe<br>migrimi<br>2021 |
|-----------------------------------------------|---------------------------|----------|--------------------------------------------|-----------------------|----------|-----------------------------------|----------------------------------------------|--------------------------------------------------|
|                                               | Imigrimi                  | Emigrimi | Bilanci i<br>migrimit<br>ndërkomb-<br>ëtar | Imigrimi              | Emigrimi | Bilanci i<br>Migrimit<br>Kombëtar |                                              |                                                  |
|                                               | 103                       | 406      | -303                                       | 162                   | 137      | 25                                | -278                                         | 40903                                            |

#### 1.3.4 Gjendja e mjedisit dhe biodiversiteti

##### Mjedisi

Komuna e Istogut ka një ekspozim dhe cënueshmëri të konsiderueshme ndaj fatkeqësive natyrore. Sipas të dhënave të mbledhura nga disa burime, mund të konkludojmë se rreziqet kryesore nga fatkeqësitë natyrore, me të cilat përballlet komuna e Istogut, apo të cilat kanë shkaktuar pasojat më të rënda në të kaluarën, janë: termetet, erërat e forta lokale dhe vërshimet e përcjellura edhe me erozion.<sup>4</sup>

##### Ndotja e ajrit

Komuna e Istogut, me pozitën e përshtatshme gjeografike që ka, larg shkaktarëve kryesor të ndotjes në nivel të Kosovës, mund të konsiderohet ndër komunat me cilësinë më të mirë të ajrit.<sup>5</sup> Nuk ka stabilimente të industrisë së rëndë që do të mund të konsideroheshin si burim kryesor i ndotjes së ajrit. Edhe ato ndërmarrje publike, prodhuese apo shërbyese, që kanë funksionuar në sistemin e kaluar, sot ose nuk ekzistojnë fare ose funksionojnë me kapacitet të reduktuar, dhe nuk paraqesin burime të përfillshme të ndotjes. Bazuar në këto mund të konkludojmë se burimet potenciale të ndotjes së ajrit në komunë, e veqanërisht në zonat urbane dhe vendbanimet me dendësi më të madhe të ndërtimit, janë:

- Trafiku dhe transporti
- Ndezjet për përfitim të energjisë për ngrohje
- Gjeneratorët për prodhim të energjisë
- Aktivitetet e ndërtimit
- Guroret e hapura për eksploatim

##### Ndotja e ujit

<sup>3</sup> Popullsia e Kosovës, 2021, ASK

<sup>4</sup> Plani Zhvillimor Komunal 2017-2027

<sup>5</sup> DesInventar-Disaster Information Management System

Ndotësit kryesorë të ujërave sipërfaqësor janë vendbanimet, ku ujërat e zeza shkarkohen pa kontroll dhe pa trajtim paraprak në lumenj duke shkaktuar kështu ndotjen ujërave me material organike dhe mikrobiologjike. Nuk ka impiant për trajtim të ujërave të ndotura. Impiantet për trajtimin e ujërave të zeza siç është rasti me impiantin e ndërtuar në fshatin Bajicë - i planifikuar për trajtimin e ujërave të zeza të disa vendbanimeve - i cili është tërësisht jashtë funksionit. Dukuri negativ që ka ndikuar në ndotjen e ujërave është edhe hedhja e mbeturinave përgjatë rrjedhave ujore që ndikon negativisht edhe në ujërat sipërfaqësor. Deponitë e mbeturinave të ndryshme të ndërtuara jashtë standarteve, në sipërfaqet tokësore, ndikojnë negativisht në ujërat nëntokësor dhe ato sipërfaqësorë. Faktorë tjetër është edhe përdorimi joprofesional i kimikateve, që kryesisht përdoren në bujqësi, në mënyrë direkte ndikojnë në ndotjen e mjedisit. Në bazë të të dhënave nga PHK, shkalla e ndotjes së ujit në lumenjtë kryesorë të Istogut është me sa vijon: Pjesët e rrjedhave ujore Istog dhe Vrelle deri në bashkimin e tyre, konsiderohen të ndotur në shkallën I të ndotjes, ndërsa rrjedha e lumit Drin dhe pjesa e rrjedhës së lumit Istog deri në derdhjen në Drin, të ndotura në shkallën II-a.<sup>6</sup>

#### Ndotja e tokës

Ndër shkaktarët e ndotjes së tokës mund të evidentohen deponia (fushëhedhurinat) komunale, e kjo ndërlidhet edhe me mangësitë komunale në menaxhimin e mbeturinave. Situata përkeqësohet pas reshjeve që pastrojnë këto deponi dhe ndotin tokën. Gjithashtu problematike janë edhe deponitë joformale të materialeve inerte që u formuan kryesisht pas luftës së vitit 1999 dhe fazës së rindërtimit të vendbanimeve. Faktorë tjetër është edhe përdorimi joadekuat i pesticideve në bujqësi, që ndikojnë në ndotjen e tokës dhe mjedisit në përgjithësi.<sup>7</sup> Ndër shkaktarët e degradimit të tokës është shkatërrimi i pyjeve nga prerja ilegale dhe nga zjarret. Si pasojë dëmtimet e pyjeve në territorin e komunës janë të konsiderueshme dhe shumë vështirë të riparueshme. Për më tepër ende nuk ka ndonjë vlerësim në shkallë vendi apo komune për përmasat e dëmtimit të pyjeve. Më të dëmtuara dhe të rrezikuara janë bjeshkët që shtrihen mbi vendbanimet prej Istogut e deri në Çerkolez.

#### Biodiversiteti

Biodiversiteti në territorin e Komunës së Istogut është mjaftë e larmishme. Ndër llojet më karakteristike të florës janë: breu, ahu, bungu, por të diferencuar mirë rriten edhe çarri, shparri, rrap (tash i kapluar nga një sëmundje, gjendet në fazën e zhdukjes si lloj), frashëri, shkoza, panja dhe çetinat e ulëta në lartësinë malore mbi 1500m. Si lloje të grupuara dhe të veçuara rriten edhe lajthia, bliri, sheldu, verri, akacia etj.

Llojet më reprezentative të faunës së "Bjeshkëve të Nemuna", duke përfshirë në këtë mes edhe "Bjeshkët e Istogut" me "Moknen", janë: rrëqebulli (Lynx lynx), ariu i murrmë (Ursus arctos), kaprolli (Capreolus capreolus), dhia e egër (Rupicapra rupicapra), shqiponja

<sup>6</sup> Plan i Zhvillimit Komunal 2017-2027

<sup>7</sup> Plan i Zhvillimit Komunal 2017-2027

## Komuna e Istogut

perandorake (Aquila heliaca), shqiponja e maleve (Aquila chrysaetos), fajkoi thonjëbardhë (Falco naummani), pulegra (Tetrao urogallus) etj., kanë status kombëtar dhe ndërkombëtar të mbrojtur. Ato gjenden në listën e IUCN-së (Unioni botëror për ruajtjen e natyrës), EU-RL (Lista e kuqe Evropiane), ĒR-RL (Lista e kuqe botërore), LKSH (Libri i kuq i Shqipërisë), LKGJ (Ligji i Kosovës për Gjuetinë) etj. Në ujërat e lumit të "Istogut" rriten këto lloje të peshqve: bërcaku, mustaku, ngjala, trofta, trofta e prrojeve, krapuliqi, dylmori dhe trofta e Danubit. Në këta lumenj ka edhe gaforre, bretkosa dhe breshka.<sup>8</sup>

### 1.3.5 Të dhënat për ekonomin lokale

Segmentet ekonomike më të zhvilluara në Komunën e Istogut janë bujqësia (prodhimtaria primare), blegtoaria (fermat e gjedheve, deleve, dhive, fermat e peshqve, etj), industria, ndërtimtaria, tregtia, shërbimet, (hoteleria, turizmi shëndetësor) etj. Ekonomia kryesisht bazohet në bujqësi me rreth 60 % të qytetarëve të angazhuar në këtë sektor (rreth 80% para konfliktit të vitit 1999). Edhe pse ka pasur rënie të aktiviteteve në këtë sektor, dhe pjesërisht mungesë të investimeve, prodhimi agrar pati një rritje. Në zhvillimin ekonomik komunal, rol dominant ka qyteti i Istogut, sepse shumica e kapaciteteve ekonomike janë të koncentruara në këtë qendër. Rol të rëndësishëm kanë edhe Banja me kapacitetet e veta turistike, pastaj Gjirakoci dhe Vrella, ndërsa lokalitetet tjera janë të shpërndara në fshatrat tjera. Gjithashtu, duhet cekur se shumë kapacitete ekonomike janë të vendosura buzë rrugëve të asfaltuar. Sipas të dhënave të komunës, në Istog në vitin 2016 ka pasur 2604 biznese të regjistruara. Ky numër ka shënuar rritje të konsiderueshme në krahasim me një vit më herët, ku në vitin 2015 kishte 2084 biznese të regjistruara, ndërsa mesatarja e rritjes së bizneseve në vit është rreth 150.

Tabela 3. Numri ndërmarrje të regulltë në komunën e Istogut

| Sektori                                                                                 | Nr. Bizneseve | %     |
|-----------------------------------------------------------------------------------------|---------------|-------|
| Tregtia me pakice ne dyqane jo te specializuar, ku mbizoteron ushqimi, pijet dhe duhani | 301           | 11.56 |
| Aktiviteti i taksive                                                                    | 218           | 8.37  |
| Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore                                           | 132           | 5.07  |
| Rritja e gjedheve per qumesht                                                           | 97            | 3.73  |
| Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve                                                  | 89            | 3.42  |
| Fermt e perziera                                                                        | 48            | 1.84  |
| Tregtia me pakice e veshjeve ne dyqane te specializuara                                 | 42            | 1.61  |
| Tregtia me shumice e drurit, materialeve te ndertimit dhe pa jisjeve hidrosanitare      | 41            | 1.57  |
| Kultivimi i dritherave (perveorizit), i bimeve bishtajore dhe i farerave va jore        | 38            | 1.46  |
| Prodhimii bukes, simiteve dhe embelsirave te fresketa                                   | 36            | 1.38  |
| Punime suvatimi                                                                         | 31            | 1.19  |
| Tregtia me pakice e karburantit per automjete ne dyqane te specializuar                 | 27            | 1.04  |
| Tregtia me pakice e tekstileve ne dyqane te specializuara                               | 29            | 1.11  |

<sup>8</sup> Plani lokal I Veprimit ne Mjedis -2012-2017

#### Komuna e Istogut

|                                                                                            |             |               |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|---------------|
| Tregtia me pakice e artikujve elektronike, ngjyrave dhe xhamit, ne dyqane te specializuara | 21          | 0.81          |
| Tregtia me pakice e mallrave te tjera te reja, ne dyqane te specializuara                  | 26          | 1.00          |
| Transporti tjetër rrugor i pasagjereve p.k.t.                                              | 40          | 1.54          |
| Hotelet dhe akomodimi i ngjashëm                                                           | 94          | 3.61          |
| Restorantet dhe aktivitetet sherbyese levizese te ushqimit                                 | 87          | 3.34          |
| Furnizimi me ushqim me porosi per raste                                                    | 26          | 1.00          |
| Aktivitetet sherbyese te pijeve                                                            | 42          | 1.61          |
| Tjera*                                                                                     | 1139        | 43.74         |
| <b>Gjithsej</b>                                                                            | <b>2604</b> | <b>100.00</b> |

Fuqia punëtore në komunën e Istogut llogaritet 40.5%. Shkalla e punësimit është mjaft e ulët, duke marrë për bazë numrin e popullsisë aktive për punë. Shkalla e punësimit është 22.5% (është llogaritur raporti mes personave të punësuar dhe gjithsej personave të moshës 15-64 vjeç (25 504 persona). Shkalla e papunësisë është 44, 3% apo 4579 persona.

Në sektorin e industrisë punojnë 437 persona apo 7.6%, në sektorin e bujqësisë 705 persona apo 12.3%, në sektorin ndërtimtar, tregti dhe shërbime 2215 persona apo 38.5%, në sektorin e administratës publike, arsimit, shëndetësisë, shërbimeve sociale 2333 persona apo 40.6% dhe 1% në sektorë tjerë. Nga kjo del se në sektorin public punojnë 2333 persona, ndërsa pjesa tjetër në sektorin privat.

#### 1.3.6 Bujqësia

Sektori i bujqësisë në Komunën e Istogut, konsiderohet si sektori më i rëndësishëm ndër aktivitetet e përgjithshme ekonomike Komuna e Istogut ka një potencial të madh në sektorin e bujqësisë. Sipas regjistrimit të bujqësisë të vitit 2014 nga ASK, fuqia punëtore në bujqësi llogaritet 13 921 persona. Pjesa fushore, ku është e lokalizuar prodhimtaria kryesore bujqësore është në lartësi mbidetare 400- 650 m, ndërsa në regjionin e bjeshkëve të Istogut kjo lartësi arrin në disa pjesë edhe në mbi 2000 m. Ky sektor merret me prodhimin e drithërave, pemëve, perimeve si dhe prodhimeve të mishit. Gjithsej sipërfaqja e tokës për shfrytëzim është 23443.52 ha. Siperfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore është 20653.91 ha gjithsej. Prej tyre 11124.83 ha janë livadhe dhe kullota. Toka e punueshme-arat gjithsej 9091.08 ha, 66 % prej tyre e zënë drithërat-ku më së shumti kultivohet gruri, misri, tërshëra, thekra, elbi. Kulturat foragjere 23,6 % (jonxha, misri i gjelbër, tërfili, etj). Pjesën tjetër e përbëjnë perimet, bishtajoret, patatet, bimët aromatike, etj. dhe vetëm rreth 1% është djerrinë. Numri i ekonomive bujqësore në tërë komunën është 5063, prej të cilave shumica dërmuese janë ekonomi familjare dhe vetëm 12 subjekte juridike. Plantacionet e pemëve përfshijnë 313.59 ha.

Sa i përket ujitjes së tokës së kultivuar, në Istog ujiten 4753 ha apo 47.7 % e sipërfaqes së tokës bujqësore. Sipas KRU Drini i Bardhë - Pejë sipërfaqja e projektuar për ujitje është 11,700 ha, ndërsa sipërfaqje të mundshme për ujitje janë 4580 ha.

Komuna e Istogut është e njohur me fermtat për kultivimin e peshkut. Prej sipërfaqeve ujore, afër 9 ha janë hurdha. Brenda qytetit të Istogut hasim edhe 6 hurdha të tjera, por të

kapaciteteve më të vogla. Hurdha të tjera të këtyre kapaciteteve i hasim edhe në disa vende të tjera në territorin e komunës së Istogut. Pra, prodhimi i peshkut konsiderohet një veprimtari me rëndësi për komunën dhe ka perspektivë në zhvillimin e mëtejshëm, duke u bazuar në pasurinë e resurseve të ujit.

#### 1.3.7 Turizmi lokal

Turizmi lokal në Komunën e Istogut është mjaftë i zhvilluar. Kultivimit të turizmit në Komunën e Istogut i ndihmon Parku Kombëtar, Parku natyrore, Burimet ujore dhe shërbimet hoteliere me peshkun e frekset. Produkti turistik që sot e ofron kjo komunë, gjithashtu mbështetet edhe në qendrën termale rehabilituese të Banjës dhe turizmin ditor ekskursionist në qytetin e Istogut dhe në Banjë. Meq ekzistojnë disa hurdha të kultivimit të peshqëve, shumë turist vendor dhe të huaj frekuentojnë në restorante ku shërbehet peshku i kultivuar në burimin e ujit të ftoftë të bjeshkëve të Istogut. Në sezonën verore numri i turistëve është më i rritur, cka dëshmon edhe gjenerimi i mbeturinave që është me i lartë për kokë banore.

Banja e Istogut, i njohur në opinion si lligja e Pejës, është njëra ndër pikat me atraktive për tretman jo vetëm turistik por edhe rehabilitues. Përveç kësaj janë dhomat e tretmanit për hidroterapi, parafino terapi, elektro-terapi dhe palestra për ushtrime fizioterapi. Ka një sipërfaqe prej 20 000 m<sup>2</sup>. Gjithashtu Banja vizitohet edhe nga ekskursionet ditore, të cilat kanë destinacion burimin e ujit termal dhe qendrën në tërësi. Qyteti i Istogut vizitohet shpesh nga ekskursionet ditore, që kryesisht destinim kanë burimin e ujit natyral mbi vendbanim dhe hurdhen e peshqve me kapacitetet e veta hoteliere dhe shërbyese.

#### 1.3.8 Institucionet publike

##### Administrata publike

Ndërtesa kryesore e institucionit të administratës publike gjendet në qendrën komunale dmth në qytetin e Istogut. Në kuadër sistemit organizative të Komunës së Istogut kemi këtë strukturë, shih figurën 2.

Mirëpo shërbimet administrative bëhen edhe në nivel të disa qendrave të bashkësisë lokale si: Gurakoc, Banjë, Vrellë, Rakosh. Zyrat postare dhe ato bankare janë shërbimet tjera të rëndësishme që poashtu duhet të ofrohen në nivel të qendrave bashkësisë lokale. Shërbimet e tilla gjendet edhe në Gurakoc, Banjë, Vrellë, Rakosh, Osojan. Sipërfaqja për banor për ndërtesat e institucioneve të administratës publike është 0.62 m<sup>2</sup>. Banor, ndërsa indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim është 80% (përrjashtim të burgjeve).<sup>9</sup>

##### Infrastruktura publike me rëndësi qëndore

Qendra korrektuese në Dubravë gjendet në mes fshatrave Dubravë, Bellopojë, Mojstir dhe Synejë, dhe në mes të rrugës rajonale Bellopojë-Istog dhe rrugës primare lokale Synejë. Sipërfaqja e ngastrës është ~24.1 ha.

<sup>9</sup> Udhëzimi Administrativ MMPH- NR.08/2017 Për normat teknike të planifikimit hapësinor, fq 84,




Fig.2. Shtruktura organizative e Komunës së Istogut

### 1.3.9 Arsimi

Në komunën e Istogut arsimit është i organizuar në dy nivele; Institucionet e arsimit parashkollor dhe Institucionet e arsimit para-universitar.

Arsimi parashkollor – ekzistojnë 5 institucione parashkollore publike (çerdhe dhe kopshte) me 275 fëmijë të regjistruar, përdërisa kapaciteti i tyre është 350 fëmijë.

Arsimi parafillor zhvillohet në objektet e shkollave fillore, ku janë të regjistruar (për vitin 2018/2019) 428 fëmijë. Numri i çerdheve-kopshteve është shumë i vogël krahasuar me standardet, ku popullsia e shërbyer nga një institucion është 2000 banorë ndërsa rrezja e shërbimit është:

Tabela 4. Rrezja shërbyese optimale në vijën ajrore (m)

|        | Rrezja shërbyese optimale në vijën ajrore (m) |                       |
|--------|-----------------------------------------------|-----------------------|
|        | Per vendbanime urbane                         | Per vendbanime rurale |
| Çerdhe | 300                                           | 300                   |

**Commented [AN3]:** Te perditesohet organogrami ku ne dr, e shendetis dhe mirqenles sociale te ndahen dhe Drejtorati per planifikim urban dhe mjedis, Drejtoria per sherbime publike ndahet ne Dr per sherbime publike dhe Dr, per Emergjence dhe shpetim

d.m.th komuna do të duhej të kishte 25-30 institucione parashkollore, nëse merret për bazë popullsia e shërbyer, ndërsa edhe më shumë nëse si kriter merret largësia më e madhe e lejuar shtëpi-çerdhe. Mirëpo, në realitet as kapaciteti i këtyre objekteve që i kemi sot nuk shfrytëzohet i tëri, si pasojë e nivelit të zhvillimit ekonomiko-social të popullsisë.<sup>10</sup>

Numri i nxënësve në vitin 2018/19 në kopshte ishte 275 fëmijë, në nivelin para fillor 428 nxënës, në nivelin 1-5 është 2914 nxënës, në nivelin 6-9 është 2297 nxënës, në nivelin 10-12 është 1557 nxënës. Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët është i organizuar në 11 shkolla filllore amë dhe 15 paralele të ndara. Prej tyre, 2 shkolla amë janë serbe, 1 është shkollë amë-mikse (shqipe-boshnjake) dhe 10 shkolla amë shqipe, ndërsa paralelet e ndara janë 1 mikse dhe 14 shqipe. Në shkollimin fillor janë regjistruar për vitin 2018/2019 gjithsej 7471 nxënës në 308 paralele. Hapësira e shkollave, sipas vlerësimeve nga DKA, është 29.69 m<sup>2</sup>/nxënës.

Arsimi i mesëm i lartë është i organizuar në dy institucione shkollore, në gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog dhe SHMT "Mithat Frashëri" në Gjurakoc, ndërsa një paralele e ndarë e SHMT-së funksionon brenda burgut të Dubravës. Numri i përgjithshëm i nxënësve që vijnë në mësimin e mesëm të lartë është 1967 nxënës.

#### 1.3.10 Shëndetësia

Në komunë gjenden gjithsej 14 objekte në të cilat ofrohen shërbime shëndetësore. Shërbimi publik shëndetësor në komunën e Istogut është i organizuar në tri nivele:

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), e cila gjendet në Istog,
- Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) në Banjë, Vrellë, Rakosh, Gjurakoc dhe
- Punktet e mjekësisë familjare në Kaliçan, Dobrushë, Saradran, Veriq, Çërkolez, Osojan, Zallq, Shushicë, Dubravë

Në pjesën grafike, zona e shërbimit është ajo që shtrihet brenda rrethit me rreze 10 km për ndërtesat e qendrave të mjekësisë familjare dhe 3 km të punkteve të mjekësisë familjare, që paraqet distancën maksimale të lejuar shtëpi-shërbim mjekësor, ku pjesë të mëdha të vendbanimeve shtrihen jashtë kësaj zone. Planet e komunës janë: ndërtimi i dy punkteve të mjekësisë familjare (në Kërninë dhe Padalishtë) si dhe ordinancave stomatologjike nëpër shkolla fillore në Gjurakoc, Istog, Vrellë dhe Banjë. Në komunën e Istogut gjenden 17 qendra private shëndetësore, prej të cilave 5 janë qendra private dentare, për të cilat nuk kemi informata më të hollësishme.<sup>11</sup>

#### 1.3.11 Dokumentet relevante komunale

##### Plani zhvillimor komunal i Istogut 2018-2026

Commented [AN4]: 2019-2027

Plani Zhvillimor Komunal duhet të sigurojë një kornizë të zhvillimit afatgjatë të Komunës, duke përcaktuar qëllimet afatgjate të zhvillimit dhe duke identifikuar prioritetet strategjike me të cilat duhet të sigurojnë:

<sup>10</sup> Drejtoria Komonale e Arsimit. Numri i nxënësve në fillim të vitit shkollor 2018/19 Plani Zhvillimor Komunal 2017-2027

<sup>11</sup> Drejtoria Komonale e Arsimit. Numri i nxënësve në fillim të vitit shkollor 2018/19 Plani Zhvillimor Komunal 2017-2027

#### **Komuna e Istogut**

- Një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, me më shumë vende të reja të punës
- Një zhvillim të përparuar social dhe mundësi të barabarta të qasjes për të gjithë
- Mbrojtje dhe zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit – resurseve natyrore dhe kulturore
- Një infrastrukturë të integruar dhe shërbime efikase për qytetarët.
- Në kuadër të këtij dokumente përfshihet edhe Plani menaxhues i mbeturinave 2016-2021, i cili përcakton politikën komunale të menaxhimit të mbeturinave dhe përgjegjesit.

#### **Vlerësimi Strategjik Mjedisore i Hartës Zonale të Komunës së Istogut, 2021**

Objektivi kryesor i VSM-së është orientimi i Hartës Zonale Komunale të Istogut për minimizimin e çdo ndikimi potencial negativ që mund të rezultojë nga zbatimi i tij.

Plani operativ emergjent lokal i Istogut

## 2 Gjendja ekzistuese e menaxhimit të beturinave

### 2.1 Të dhënat për mbeturinat komunale

Bazuar në Raportin vjetor të AMMK për vitin 2021 gjenerimi i mbeturinave në Komunën e Istogut është paraqitur në tab. 5. Komuna e Istogut nuk ka zhvilluar ndonjë analizë të gjenerimit të mbeturinave. Gjenerimi i mbeturinave të grumbulluara në bazë të peshimit në deponinë lokale të Tuçepit ku dërgohen të gjitha mbeturinat.

Sasia e mbeturinave të grumbulluara dhe deponuara 2021 nga ndërmarrja "Ambienti"

| Viti | Mbeturina të grumbulluara nga Ambienti (ton) | Mbeturina të grumbulluara nga deponitë ilegale (ton) | Mbeturina të ripërdorura / ricikluara | Totali i sasisë së mbeturinave të deponuara nga Ambienti (ton) |
|------|----------------------------------------------|------------------------------------------------------|---------------------------------------|----------------------------------------------------------------|
| 2021 | 16,256 t                                     | NA                                                   | -                                     | 16,252 t                                                       |

Në lidhje me kompozicionin/ përbërjen e mbeturinave nuk është bërë ndonjë analizë. Meqë Komuna e Istogut hynë në kuadër të regjionit të Pejës, në lidhje me kompozicionin e mbeturinave do marrim si analizë vlerësimi nga rasti i Komunës së Pejës. Përbërja e sasisë dhe llojit të mbeturinave e cila ka rezultuar nga analizat ka qenë ma vijon, shih tabelen 6.

Tabela 6. Kompozicioni i mbeturinave bazuar në analizën e kompozicionit të mbeturinave 2020-2021 (komuna e Pejës).

| Lloji i mbeturinave                                  | Analiza e parë A1<br>2021 |                | Analiza e dytë A2<br>2022 |                | Mesatarja nga A1 dhe A2 |
|------------------------------------------------------|---------------------------|----------------|---------------------------|----------------|-------------------------|
|                                                      | Kilogram                  | Përbërja në %  | Kilogram                  | Përbërja në %  | Përbërja në %           |
| <b>Mbeturinat Komunale</b>                           |                           |                |                           |                |                         |
| Letër dhe karton                                     | 439.63                    | 21.30%         | 355.3                     | 17.00%         | 19.15%                  |
| Qelq                                                 | 119.71                    | 5.80%          | 148.39                    | 7.10%          | 6.45%                   |
| Mbeturina të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat | 633.65                    | 30.70%         | 798.38                    | 38.20%         | 34.45%                  |
| Tekstil                                              | 132.10                    | 6.40%          | 110.77                    | 5.30%          | 5.85%                   |
| Plastikë                                             | 392.16                    | 19.00%         | 415.91                    | 19.90%         | 19.45%                  |
| Metal                                                | 22.70                     | 1.10%          | 20.9                      | 1.00%          | 1.05%                   |
| Mbeturina tjera komunale                             | 324.05                    | 15.70%         | 240.35                    | 11.50%         | 13.60%                  |
| <b>Totali në kg dhe në %</b>                         | <b>2,064</b>              | <b>100.00%</b> | <b>2,090</b>              | <b>100.00%</b> | <b>100.00%</b>          |

### 2.2 Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

#### 2.2.1 Operatorët e shërbimit të grumbullimit dhe transportit

Grumbullimin e mbeturinave në Komunën e Istogut bëhet nga KRM "Ambienti", njësi operative në Istog. KRM "Ambienti", është nën përgjegjësin dhe i autorizuar nga Komuna e Istogut.

## Komuna e Istogut

Krahas këtij operatori ekzistojnë edhe disa operatorë të riciklimit të cilët janë të palicencuar dhe të cilët nuk janë pjesë e sistemit të organizuar të menaxhimit të mbeturinave.

Tabela 8: Operatorët për menaxhimin e mbeturinave nën përgjegjësin komunale

|             | Emri i operatorit (biznesit)          | Forma e pronësisë | Kategoria e menaxhimit të mbeturinave | Mbulimi me shërbim %                | Statusi i kontraktimit (po/jo) |
|-------------|---------------------------------------|-------------------|---------------------------------------|-------------------------------------|--------------------------------|
| Operatori 1 | KRM "Ambienti" Njësia Operative Istog | Publike           | Mbeturina komunale                    | 90 të ekonomive familjare në komunë | Marrëveshje për shërbim        |

Tabela 9: Operatorët tjerë të mbeturinave që operojnë në territorin e komunës

|             | Emri i operatorit (biznesit) | Forma e pronësisë | Kategoria e mbeturinave të menaxhuara | Sasia e mbeturinave të menaxhuara |
|-------------|------------------------------|-------------------|---------------------------------------|-----------------------------------|
| Operatori 1 | NA                           |                   |                                       |                                   |

### 2.2.2 Mbulimi me shërbim

Mbulimi me shërbim për grumbullim të mbeturinave në Komunën e Istogut është 90 %, shih tabelen 10. Nëse krahasohet me vitin 2021, mbulueshmeri është rritur për 16.10%.<sup>12</sup>

Tabela 10: Mbulimi me shërbim në territorin e komunës<sup>3</sup>

| Emri i operatorit | Numri i EF | Numri i EF të shërbyera | Numri i bizneseve aktive | Numri i bizneseve të shërbyera | Numri i institucioneve të shërbyera |
|-------------------|------------|-------------------------|--------------------------|--------------------------------|-------------------------------------|
| KRM "Ambienti"    | 6,741      | 6,065                   | -                        | 664                            | 50                                  |

Komuna e Istogut ka 50 vendbanime të përfshirë edhe qëndren e qytezës së Istogut. Mbulimi me shërbime sipas vendbanimeve po paraqesim në tabelen 11. edhe për mbeturina të ndara në burim. Ndërsa në shumë vendbanime numri i shërbimit për EF është me i madhë sesa numri i EF të regjistruara. Kjo është si rezultat i levizjeve të popullatës.

Nëse i referohemi statistikave të vitit 2011 për EF dhe numrin e EF të shërbyera për vitin 2021, atëherë kemi këtë %, shih tabelen 11.

% e mbulimit me shërbim për vendbanimet nuk korespondon me të dhënat e mbulueshmeri total prej 90% sipas raportit të vitit 2021- AMMK.

Tabela 11. Mbulimi i shërbimit për EF sipas vendbanimeve

| Nr. | Vendbanimi | Numri i EF (ASK 2011) | Numri EF të shërbyera | Mbulimi me shërbim % | Numri EF me ndarje në burim | EF me ndarje në burim % | Lloji i ndarjes së mbeturinave <sup>13</sup> |
|-----|------------|-----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------------|-------------------------|----------------------------------------------|
| 1   | Banjë      | 277                   | 330                   | 119.13               | 0                           | 0                       |                                              |
| 2   | Banjicë    | 105                   | 61                    | 58.09                | 0                           | 0                       |                                              |

<sup>12</sup> Raporti për gjendjen e mbeturinave në Kosovë për vitin 2021, AMMK (2022)

<sup>13</sup> Spjego infrastrukturën ndarëse të EF, psh., pajisje me komposter individual, sistem me dy shporta (riciklueshme të paraciklueshme)

Komuna e Istogut

|        |                 |      |                    |         |   |   |
|--------|-----------------|------|--------------------|---------|---|---|
| 3      | Belicë          | 10   | Pa banushme        | 0.00    | 0 | 0 |
| 4      | Bellopoje       | 27   | 130                | 481.48  | 0 | 0 |
| 5      | Carrallukë      | 94   | 50                 | 53.19   | 0 | 0 |
| 6      | Cerkoleezë      | 50   | 20                 | 40      | 0 | 0 |
| 7      | Cerrcë          | 215  | 264                | 122.79  | 0 | 0 |
| 8      | Dobrushë        | 242  | 170                | 70.24   | 0 | 0 |
| 9      | Dragolec        | 73   | 48                 | 65.75   | 0 | 0 |
| 10     | Drejë           | 61   | 85                 | 139.34  | 0 | 0 |
| 11     | Dubovë e Vogël  | 49   | 47                 | 95.91   | 0 | 0 |
| 12     | Dubravë         | 124  | 157                | 126.61  | 0 | 0 |
| 13     | Gjurakoc        | 410  | 370                | 90.24   | 0 | 0 |
| 14     | Istog           | 992  | 1130               | 113.91  | 0 | 0 |
| 15     | Istog I Poshtëm | 106  | 264                | 249.05  | 0 | 0 |
| 16     | Kaliqan         | 149  | 193                | 129.53  | 0 | 0 |
| 17     | Kashicë         | 86   | 150                | 174.41  | 0 | 0 |
| 18     | Kërninë         | 77   | 80                 | 103.89  | 0 | 0 |
| 19     | Kosh            | 36   | 26                 | 72.22   | 0 | 0 |
| 20     | Kovragë         | 124  | 190                | 153.22  | 0 | 0 |
| 21     | Lubovë          | 138  | 110                | 79.71   | 0 | 0 |
| 22     | Lubozhdë        | 165  | 123                | 74.54   | 0 | 0 |
| 23     | Llugë           | 89   | 72                 | 80.89   | 0 | 0 |
| 24     | Llukac I Begut  | 192  | 114                | 59.37   | 0 | 0 |
| 25     | Llukac I Thatë  | 32   | 20                 | 62.5    | 0 | 0 |
| 26     | Mojstirë        | 37   | 103                | 278.37  | 0 | 0 |
| 27     | Muzhevinë       | 110  | 131                | 119.09  | 0 | 0 |
| 28     | Orobërd         | 196  | 155                | 79.08   | 0 | 0 |
| 29     | Osojan          | 28   | 78                 | 278.57  | 0 | 0 |
| 30     | Polanë          | 2    | Pa banushme        | 0.0     | 0 | 0 |
| 31     | Prekallë        | 63   | 49                 | 77.77   | 0 | 0 |
| 32     | Prigodë         | 98   | 100                | 102.04  | 0 | 0 |
| 33     | Rakosh          | 137  | 108                | 78.83   | 0 | 0 |
| 34     | Serbobran       | 53   | 35                 | 25.54   | 0 | 0 |
| 35     | Sinajë          | 40   | 51                 | 127.5   | 0 | 0 |
| 36     | Staradran       | 256  | 154                | 60.15   | 0 | 0 |
| 37     | Studenicë       | 243  | 228                | 93.82   | 0 | 0 |
| 38     | Suhogërlë       | 133  | 71                 | 53.38   | 0 | 0 |
| 39     | Shalinovicë     | 18   | 12                 | 66.66   | 0 | 0 |
| 40     | Shushicë        | 240  | 50                 | 20.83   | 0 | 0 |
| 41     | Tomoc           | 132  | 225                | 170.45  | 0 | 0 |
| 42     | Trubuhoc        | 141  | 79                 | 56.03   | 0 | 0 |
| 43     | Tuqep           | 3    | 4                  | 133.33  | 0 | 0 |
| 44     | Uçë             | 121  | 126                | 104.13  | 0 | 0 |
| 45     | Veriq           | 71   | 21                 | 29.57   | 0 | 0 |
| 46     | Veriq I Ri      | 5    | 5                  | 100.00  | 0 | 0 |
| 47     | Vrellë          | 472  | 473                | 100.21  | 0 | 0 |
| 48     | Zabllaq         | 79   | 67                 | 84.81   | 0 | 0 |
| 49     | Zallq           | 89   | 71                 | 79.77   | 0 | 0 |
| 50     | Zhakovë         | 51   | 40                 | 78.43   | 0 | 0 |
| Totali |                 | 6741 | (6065, sipas AMMK) | 104.28% |   |   |

Në vendbanimet Belicë të evidentuar me ekonomi familjare 10 dhe Polan me 2, nuk kemi shërbim për shkak se nuk ka banorë.

## 2.2.3 Tipologjia e ofrimit të shërbimit

Ofrimi i shërbimit për grumbullim të mbeturinave në Komunën e Istogut është e ndarë dy zona: zona urbane qendra, dhe zona rurale. Tabela në vijim e ndanë zonën e shërbimit në tre seksione: zona urbane qendra, dhe zona rurale. Në qytet mënyra predominante e shërbimit është me kontejnerë të përbashkët ndërsa në zonën rurale forma e shërbimit është derë më derë. Frekuenca e shërbimit për zonën urbane është 1 – 2 herë në ditë varësisht nga sezona dhe gjenerimi i mbeturinave ndërsa në zonën rurale mbeturinat grumbullohen një herë në javë. Sa i përket infrastrukturës ndarëse ajo nuk ekziston në komunë dhe mbeturinat hedhen në kontejnerë/shprta në mënyrë të përzier dhe si të tilla grumbullohen nga operatori.

Tabela 12: Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit

| Vendbanimi                       | EF të shërbyera derë më derë % | Frekuenca e shërbimit | EF të shërbyera me shporta / kontejnerë të përbashkët % | Frekuenca e shërbimit |
|----------------------------------|--------------------------------|-----------------------|---------------------------------------------------------|-----------------------|
| Zona urbane qendra <sup>14</sup> | 15%                            | 6 dite në javë        | 85%                                                     | (çdo ditë)            |
| Zona rurale                      | 100%                           | 1 herë në javë        | -                                                       | -                     |

## 2.2.4. Asetet e huthjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale

Asetet e huthjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale janë nën menaxhimin e KRM "Ambienti", shih tabelen 13. Në Istog shumica e mjeteve të huthjes së mbeturinave janë shportat 120l dhe kontejnerët 1.1m<sup>3</sup>. Gjendja e këtyre pajisjeve të huthjes është kryesisht e mirë megjithatë nevojiten investime të vazhdueshme në ripërtëritjen e tyre.

Tabela 13: Pajisjet për huthjen dhe grumbullimin e mbeturinave

| Lloji i kontejnerit                     | Numri | Gjendje të mire % | Gjendje funksionale % | Gjendje jo të mire %  |
|-----------------------------------------|-------|-------------------|-----------------------|-----------------------|
| Shporta 120 l                           | 860   | 100               | -                     | -                     |
| Shporta 240 l                           | -     | -                 | -                     | -                     |
| Kontejnerë 1.1 m <sup>3</sup> metalik   | 402   | -                 | 70<br>(280 kontejner) | 30<br>(122 kontejner) |
| Kontejnerë 1.1 m <sup>3</sup> plastikë  | -     | -                 | -                     | -                     |
| Kontejnerë 5.1 m <sup>3</sup>           | 5     | -                 | 60                    | 40                    |
| Kontejnerë 7.1 m <sup>3</sup>           | 19    | -                 | 40                    | 60                    |
| Kontejnerë 30 m <sup>3</sup> - Transfer | -     | -                 | -                     | -                     |

Mjetet për transportin e mbeturinave (kamionët) dhe mjetet tjera të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale përfshi edhe atë të transferit, që janë nën menaxhimin e KRM "Ambienti", janë paraqitura në tabelen 14. Operatori i shërbimit ka në dispozicion një autopark të konsiderueshëm prej 10 kamionëve 4 prej të cilëve nuk janë në gjendje të

<sup>14</sup> Ndërtesa shumëkatëshe me banim kolektiv

## Komuna e Istogut

mirë operative. Këta kamionë janë të vjetër 20 vite e më shumë dhe si të tillë kanë defekte më të shpeshta dhe harxhim të karburanteve dhe lirim të gazrave serrë.

**Tabela 14: Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave**

| Brendi             | Tipi         | Kapaciteti ton apo m3 | Viti i prodhimit | Targat        | Gjendja (e mirë /funktionale/e keqe) |
|--------------------|--------------|-----------------------|------------------|---------------|--------------------------------------|
| Ford               | Kompaktor    | 7 T                   | 2011             | 03-671-EI     | Funksional                           |
| Mercedes Automatik | Kompaktor    | 11 T                  | 2000             | 03-571-ET     | Funksional                           |
| Ivecok Calabrez    | Kompaktor    | 7T                    | 2000             | 03-207-GO     | Funksional                           |
| Mitcubishi         | Kompaktor    | 4T                    | 2009             | 03-480-CA     | Funksional                           |
| Merceds me Grepa   | Kompaktor    | 5T                    | 1987             | 03-134-FB     | Funksional                           |
| Fap14x14           | Vetëngarkues | 7T                    | 1989             | 03-677-AH     | E keqe                               |
| Kamionet T4        | Vetëngarkues | 1T                    | 2000             | 03-453-AI     | E keqe                               |
| Mercedes 4.3t      | Vetëngarkues | 4.3T                  | 2004             | 03-206-GO     | Funksional                           |
| Man                | Vetëngarkues | 5T                    | 2007             | 03-219-HD     | Funksional                           |
| Mercedes Benz      | Vetëngarkues | 8T                    | 2022             | 03-690-HP     | E mirë                               |
| Mercedes kiperash  | Vetëngarkues | 5T                    | 1973             | 03-904-DN     | E keqe                               |
| Traktor            |              | -                     | -                | Në shfrytëzim | Funksional                           |

### 2.3.Rishikimi i implementimit të planit

Komuna e Istogut në planin e menaxhimit të mbeturinave 2016-2021, ka pasur 15 objektiva kryesorë të ndarë në të shërbimit, dhe institucional.

Në tabelën në vijim janë pasqyruar më detajisht objektivat e planit, treguesit e suksesit, caqet e planifikuara, realizimin e tyre, si dhe janë dhënë komentet konkrete për secilin objektivi. Në përgjithësi rezultatet e realizimit të caqeve janë modeste për shkak të mungesave infrastrukturore dhe kapaciteteve institucionale.

Sido që të jetë ky rishikim i PKMM aktual, duhet të na shërbej si një mësim dhe si orientim për hartimin e PKMM në vijim, me qëllim që të adresohen qartë rrethanat dhe arsyet që kanë ndikuar në mospërbushjen e objektivave.

Komuna e Istogut

Tabela 10: Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual

|     | Objektiva e MM                                                                                                                                                          | Treguesi i performancës | Caku | Realizimi | Favorshëm / pafavorshëm | Koment                                              |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|------|-----------|-------------------------|-----------------------------------------------------|
| O1  | Riorganizimi i zonave për shërbime të grumbullimit tëmbeturinave                                                                                                        | 1                       | 1    | 0         | Pafavorshëm             | Mungesa e fondeve të infrastrukturës                |
| O2  | Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime.                                                                                                                           | %                       | 100% | 90%       | Pafavorshëm             | Mungesa e fondeve të infrastrukturës                |
| O4  | Ndarja e mbeturinave në burim në shkollat publike dhe institucionet.                                                                                                    | 1                       | 1    | 0         | Pafavorshëm             | Mungesa e fondeve të infrastrukturës dhe pandemia   |
| O5  | Ndarja e mbeturinave në burim në disa lagje apo vendbanime të komunës.                                                                                                  | 1                       | 1    | 0         | Pafavorshëm             | Mungesa e fondeve të infrastrukturës dhe pandemia   |
| O6  | Ndarja e mbeturinave në sheshpublike – ishujt e gjelbër.                                                                                                                | 1                       | 1    | 0         | Pafavorshëm             | Eshte nenshkruar marreveshja, por nuk eshte filluar |
| O7  | Përcaktimi i lokacionit për pranimin e mbeturinave të vëllimshme                                                                                                        | 1                       | 1    | 1         | Favorshëm               | Lokacioni eshte percaktuar.                         |
| O8  | Krijimi i sistemit lokal të kompostimit                                                                                                                                 | 1                       | 1    | 0         | Pafavorshëm             | Mungesa e fondeve të infrastrukturës dhe pandemia   |
| O9  | Grumbullim dhe transportim i vecantë i mbeturinave shtazore.                                                                                                            | 1                       | 1    | 0         | Pafavorshëm             | Dobësi në zbatim                                    |
| O10 | Ndarja e mbeturinave medicinale nga mbeturinat komunale                                                                                                                 | 1                       | 1    | 1         | Favorshëm               |                                                     |
| O11 | Identifikimi i lokacionit për ndërtimin e qendrës grumbulluese për mbeturinat nga ndërtim demolimi                                                                      | 1                       | 1    | 1         | Favorshëm               | Lokacioni eshte percaktuar.                         |
| O12 | Miratimi i rregullores                                                                                                                                                  | 1                       | 1    | 1         | Favorshëm               | Rregullorja është hartuar dhe miratuar              |
| O13 | Emërimi i zyrtarit për menaxhim tëmbeturinave                                                                                                                           | 1                       | 1    | 1         | Pafavorshëm             |                                                     |
| O14 | Organizimi i procesit të përcaktimit të tarifave të shërbimit tëgrumbullimit tëmbeturinave komunalen                                                                    | 1                       | 1    | 1         | Favorshëm               | Procesi është zbatuar                               |
| O15 | Krijimi i kampanjës për vetëdijësim dheinformim rreth efektevepozitive dhe negative tëmbeturinave, rreth oraritdhe rregullave tëgrumbullimit dhehedhjes së mbeturinave. | 1                       | 1    | 1         | Favorshëm               | Jane mbajtuar takime sipas masave te pandemise      |

Commented [AN5]: Nuk ka zyrtar per mm andaj tani e kan hapur konkursin

## 2.3 Performance e shërbimit

### 2.3.1 Efikasiteti i stafit të ofruesit të shërbimeve

Stafi i angazhuar në ofrimin e shërbimeve përfshin stafin direkt e angazhuar në operime si dhe stafin indirekt dhe administrativ të cilët i mbështesin ofrimin e shërbimit të MM. Numri i stafit total është 66 dhe raporti staf direkt staf administrative është 64% / 36%. Në përgjithësi efikasiteti i stafit të KRM Ambienti në komunën e Istogut nuk është i favorshëm sidomos nëse treguesi kalkulohet për konsumatorë të shërbyer që shpalos mbistafim (joefikasitet të theksuar operativ).

Numri i stafit ofrues të shërbimeve në menaxhimin e mbeturinave janë gjithësejt 39. Për vitin 2021, efikasiteti i shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale në Komunën e Istogut është paraqitur në tabelen 16.

Tabela 16: Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM

| Kategoria                                            | Numri i stafit |
|------------------------------------------------------|----------------|
| <b>Stafi direkt</b>                                  |                |
| Kryepunëtorë                                         |                |
| Shoferë                                              | 6              |
| Punëtorë                                             | 19             |
| Total staf direkt:                                   | 25             |
| <b>Staf indirekt dhe administrativ</b>               |                |
| Drejtorët e bordit                                   | -              |
| Menaxhmenti i lartë <sup>15</sup>                    | -              |
| Zyrtarë të rangut të mesëm                           | 5              |
| Staf teknik                                          | 4              |
| Zyrtarë të rangut fillestar                          | 5              |
| Staf tjetër                                          | -              |
| Total staf indirekt dhe administrative:              | 14             |
| Total staf të MM                                     | 39             |
| Mbeturina të grumbulluara                            | 16,256 t       |
| Efikasiteti i stafit / ton mbeturina të grumbulluara | 2,4            |
| EF të shërbyera                                      | 6,065 EF       |
| Efikasiteti i stafit / EF të shërbyera               | 6,4            |

### 2.3.2 Performanca e aseteve të grumbullimit dhe transportit

KRM "Ambienti", e cila operon në Komunën e Istogut, ka këtë performancë të grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave, shih tabelen 17. Konsumi i naftës mesatare është 3,8 l/ton dhe i

<sup>15</sup> Kë, ZK, drejtorët e departamenteve, dhe pozita tjera të larta.

## Komuna e Istogut

njëjti është mjaft i lartë edhe pse komuna e Istogut e ka deponinë afër. Në këtë joefikasitet ka ndikuar mungesa e planit të detajuar operativ si dhe prezenca e makinerisë së vjetëruar e cila nuk është efikase.

**Tabela 17: Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave**

| Kategoria                           |             |
|-------------------------------------|-------------|
| Kamionët në operim                  | 8           |
| Kapaciteti maksimal operues (ton)   | 36          |
| Mbeturinat e Grumbulluara (ton/vit) | 16,256 ton  |
| Xhiro (xhiro/vit)                   | 2,980       |
| Kilometrazhi (km/vit)               | 174,417     |
| Konsumi i naftës (l/vit)            | 61,220      |
| <b>Efikasiteti i Shfrytëzimit %</b> |             |
| Konsumi i naftës l/100km            | 35 l/100 km |
| Konsumi i naftës l/ton              | 3.77l/ton   |

### 2.4 Performanca financiare e MM

#### 2.4.1 Shpenzimet e shërbimit të MM

Shpenzimet e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave për Komunën e Istogut për vitin 2021 janë të paraqitura në tabelen 18. Struktura e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve shpalos faktin se shumica dërmuese e shpenzimeve shkojnë në paga dhe shpenzime administrative ndërsa amortizimi është shumë i vogël për shkak të aseteve të vjetëruara. Operatori duhet të përmirësojë efikasitetin e operimit për të siguruar fonde shtesë për investime të ripërtëritjes kapitale.

**Tabela 18. Shpenzimet e shërbimit të MM**

| Kategoria e kostove dhe shpenzimeve          | Kostot (€/vjet) | Pjesëmarrja % |
|----------------------------------------------|-----------------|---------------|
| Shpenzimet e pagave                          | 269,148         | 62.56%        |
| Shpenzimet e materialit direkt <sup>16</sup> | 134,312         | 31.22         |
| Shpenzimet indirekte dhe administrative      | 13,304          | 3.09          |
| Amortizimi                                   | 134,30          | 3.12          |
| Total:                                       | 430,194         | 100%          |

#### 2.4.2 Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM

Të hyrat nga arkëtimi i shërbimit për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Istogut e bënë KRM "Ambienti". Sipas raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave për të hyrat dhe arkëtimin janë të paraqitura në tabelen 19. Amvisëritë janë kategoria më e rëndësishme e të hyrave 69% e pasuar nga bizneset 16% dhe institucionet 15%. Shkalla e arkëtimit është 103% për shkak të arkëtimit të borxheve të vjetra ndërsa për amvisëri ajo është 101%.

<sup>16</sup> Nafta, pagesa e deponisë, mirëmbajtja dhe riparimet e kamionëve dhe kontejnerëve, regjistrimi i kamionëve, etj.

## Komuna e Istogut

Tabela 19: Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM

| Të hyrat operative                   | Të hyrat |       | Arkëtimi |        |
|--------------------------------------|----------|-------|----------|--------|
|                                      | €        | %     | €        | %      |
| -Amvisëritë                          | 320834   | 69,0% | 324264   | 101,1% |
| -Bizneset                            | 74445    | 16,0% | 78385    | 105,3% |
| -Institucionet                       | 69892    | 15,0% | 76324    | 109,2% |
| -Nga shërbimet tjera të kontraktuara |          | %     |          |        |
| Total:                               | 465171   | 100%  | 478974   | 103,0% |

### 2.4.3 Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit

Mbulimi i kostos dhe efikasiteti për menaxhimin e mbeturinave komunale në Istog për vitin 2021, është paraqitur në tabelen 20. Komuna e Istogut i mbulon kostot porse kjo bëhet në kurriz të investimeve çka nuk paraqet stabilitet në periudhën afatmesme dhe afatgjate.

Tabela 20: Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit

|                                   |          |
|-----------------------------------|----------|
| Kostot e MM                       | 416764   |
| Të hyrat e MM                     | 465171   |
| Arkëtimi                          | 478974   |
| Shkalla e mbulimit nga faturim i% | 116%     |
| Shkalla e mbulimit nga arkëtimi % | 115%     |
| Kosto për ton të mbeturinave      | 25,6 €/t |

## 2.5 Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave

### 2.5.1 Qendrat e transferit dhe të riciklimit

Në komunë e Istogut nuk ka qendër të transferimit dhe riciklimit të mbeturinave. Mbeturinat e grumbulluara nga EF, bizneset dhe institucionet dergohen ne deponin e autorizuar nga komuna në Tuçep e cila në fakt fillimisht ka qenë e dizajnuar si transfer stacion ka degraduar në një depone të pakontrolluar dhe hotspot mjedisor.

### Deponia

Me autorizim të Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Istogut, është hapur një lokacionin e Tuçepit një deponi e mbeturinave. Deponia përdoret që nga viti 2002 dhe fillimisht ishte menduar që të përdoret si stacion transferi nga i cili mbeturinat do të dërgoheshin në deponin rajonale në Sferkë - Pejë. Mirëpo, me arsyetimin se distanca dhe kostoja për transport deri ne deponin sanitarë në Pejës (42 km), njësia e KRM-s "Ambienti", në Istog është duke vazhduar me deponimin e mbeturinave në këtë deponi.

Deponia nuk plotëson asnjë standardë ligjore për deponimin e mbeturinave urbane. Deponia nuk ka shtresën izoluese për mos kontaminimin e ujërave nëntokësore dhe tokës nga ujërat ndotëse të deponisë, nuk posedon as infrastrukturën përcjellëse si lagunën për deponimin e

## Komuna e Istogut

ujërave, nuk ka rrethojën dhe nuk ka të vendosura as gypat për nxjerrjen e gazrave për pjesët e mbuluar me shtresën e dheut

### 2.7.Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave

Menaxhimi i këtyre mbeturinave ende nuk është i organizuar në komunën e Istogut dhe kjo shihet si njëra nga shkaqet e prezences së hudhjes së këtyre artikujve rreth kompjuterëve dhe në deponi ilegale.

- Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi:

Komuna enden uk e ka caktuar lokacion për MND. Poashtu komuna nuk e ka kaluar procesin tariforë. Për shkak të dobësive në zbatimin ligjor është e shprehur hudhja e këtyre mbeturinave në vende të papërshtatshem duke i dhënë hov dukurisë së deponive ilegale në komunë.

- Menaxhimi i mbeturinave shtazore

Këto mbeturina shpeshherë hedhen në kontejnerë komunal dhe për rrjedhojë dëmtohet operatori i cili detyrohet të paguaj tarifa të larta si dhe në deponi ilegale. Poashtu mosrealizimi i qendrës përpunuese në Drenas e ka dëmtuar këtë kategori të mbeturinave.

- Menaxhimi i mbeturinave medicinale

Menaxhimi dhe grumbullimi i mbeturinave mjekësore bëhet nga kompani të licensuara të cilat fraksionet e mprehta dhe pajisjet i dërgojnë për sterilizim ndërsa pjesën infektive për incinerim tek qendra rajonale spitalore. Megjithatë menaxhimi i kësaj kategori të mbeturinave nuk është në nivelin e dëshiruar.

- Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave

Në komunë e Istogut nuk ka formë të organizuar të menaxhimit të kategorive tjera të mbeturinave dhe operatorët që operojnë me to nuk janë të licencuar dhe rrjedhimisht nuk i zbatojnë veprimet e tyre në harmoni me kuadrin ligjor.

### 3 Objektivat e MM dhe plani operacional

#### 3.1 Vizioni i MM

Komuna e Istogut është një komunë e cila promovon menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave të bazuar në parimet e ekonomisë qarkore me synim mbrojtjen e mjedisit, prezervimin e resurseve natyrore dhe zhvillimit ekonomik lokal!

Komuna Istogut synon që të ofrojë shërbime të menaxhimit të mbeturinave gjithë qytetarëve të saj. Krahas këtij veprimi komuna synon që të ngrisë kualitetin e shërbimeve duke bashkëpunuar më qytetarët e saj dhe akterët tjerë relevant.

Duke promovuar konceptin 3R dmth zvogëlim, ripërdorim, dhe riciklim komuna synon që gradualisht të fillojë të ndajë mbeturinat (nga ekonomi familjare, tek shkollat dhe institucionet, dhe biznese), të edukojë qytetarët rreth përfitimeve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektor. Përfundimisht, komuna synon që të krijojë një mjedis më të pastër për qytetarët e saj, gjë që do të ndikonte në ngritjen e mirëqenies për qytetarë.

#### 3.2 Objektivat dhe caqet e MM

Formati i standardizuar i PKMM përmban pesë objektiva të paraqitur në tabelën e mëposhtme (edhe pse lista nuk është e kufizuar):

**Tabela 21: Lista e propozuar e objektivave të planit**

| Numri objektivit | Emërtimi                                                             |
|------------------|----------------------------------------------------------------------|
| Objektivi 1      | Parandalimi dhe minimizimi i gjenerimit të mbeturinave               |
| Objektivi 2      | Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave                              |
| Objektivi 3      | Ofrimi i shërbimeve cilësore, efektive dhe efikase të shërbimeve     |
| Objektivi 4      | Trajtimi dhe deponimi i sigurt i mbeturinave si mjeti i fundit       |
| Objektivi 5      | Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave |

#### 3.3 Objektivi 1: Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave

Komuna e Istogut është e përkushtuar që të bëjë hapa të vendosur në parandalimin respektivisht reduktimin e gjenerimit të mbeturinave. Parandalimi dhe reduktimi i gjenerimit të mbeturinave shkon në linjë me hierarkinë e prioritetëve të menaxhimit të mbeturinave të sanksionuar me ligj dhe strategji.

**Tabela 22: Korniza strategjike e Objektivit 1**

Komuna e Istogut

| Nr. | Aktiviteti / masa                                                                         | Treguesi                                                                      | Vlera bazë |      | Caku |      |      |      |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------|------------|------|------|------|------|------|
|     |                                                                                           |                                                                               | 2022       | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| 1.1 | Mbeturina të grumbulluara për kokë banori (kg /pcp /ditë)(-2%)                            | Sasia e mbeturinave të grumbulluara nga ofruesi i shërbimeve (kg /pkb/ditë)   | 1.26       | 1.23 | 1.21 | 1.18 | 1.16 | 1.10 |
| 1.2 | Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar matjen e mbeturinave të grumbulluara            | Shërbimi është riorganizuar që të mundësoj matjen në pikën e grumbullimit     | -          | -    | 1    | -    | -    | -    |
| 1.3 | Zbatimi i tarifave volumetrike                                                            | Tarifat volumetrike janë miratuar dhe po aplikohen                            | -          | -    | 1    | -    | -    | -    |
| 1.4 | Futja e pakos stimuluese                                                                  | Pako stimuluese është hartuar dhe miratuar                                    | -          | -    | -    | 1    | -    | -    |
| 1.5 | Shpërndarja e komposterëve individual                                                     | Numri i komposterëve individual të shpërndarë për EF dhe biznese „zero ëaste“ | -          | 50   | 50   | 50   | 100  | 100  |
| 1.6 | Zbatimi i fushatës informative për parandalimi dhe minimizim të gjenerimit të mbeturinave | Fushata informative po zbatohet                                               | -          | 1    | 1    | 1    | 1    | 1    |

3.3.1 Masat dhe aktivitetet për zbatimin e Objektivit 1

**Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar zbatimin e tarifave me bazë matjen:**

Mënyra e organizimit të tanishëm të shërbimit përveq bizneseve të mëdha dhe institucioneve nuk bazohet në matjen e mbeturinave të gjeneruara për grumbullim. Edhe tek rasti i grumbullimit derë më derë për amvisërit në zonat rezidenciale dhe rurale prap nuk bëhet matja për amvisëri të shërbyer. Kjo mënyrë e shërbimit e pamundëson zbatimin e tarifave në bazë të matjes dhe si e tillë duhet të transformohet. Poashtu ofruesit e shërbimeve nuk e kanë teknikën e as kapacitetin për ta zbatuar volumetrinë.

Për të riorganizuar shërbimin komuna do të bëjë:

- **Planin e riorganizimit të shërbimit** i cili do të mundësoj zbatimin e matjes së mbeturinave në pikën e grumbullimit
- Sigurimi i infrastrukturës për matjen e gjenerimit të mbeturinave të grumbulluara

- Trajnimi i stafit të ofruesit të shërbimeve për të zbatuar skemën PAYT.

#### **Zbatimi i tarifave volumetrike bazuar në matje**

Tarifat aktuale janë të përcaktuara në bazë të sasisë së paramenduar të gjenerimit të mbeturinave për amvisëritë dhe bizneset. Problemi me këto tarifa është se nuk e promovojnë reduktimin e gjenerimit të mbeturinave përmes pagesës ndërsa disa konsumatorë me gjenerim më të madh përfitojnë nga pagesa më e ulët se kostoja e shërbimit. Për të kaluar në tarifat volumetrike do të zbatohen aktivitetet sa vijon:

- Kalimi i tarifave të shërbimit në bazë të matjes
- Azhurnimi i softuerit të faturimit që të mundësoj tarifat e bazuara në matje
- Zbatimi i tarifave PAYT

#### **Nxjerrja e pakos stimuluese për bizneset me „zero ambalazhim“ dhe „zero mbeturina“:**

Komuna ka interes që të zhvilloj ekonomi lokale të bazuar në ekonomi qarkore dhe bazë të qendrueshme. Ideja është që këto biznese të veprojnë në drejtim të minimizimit dhe reduktimit të mbeturinave. Në vendet e BEs dhe më gjerë po hapen dyqane të cilat shesin produktet e tyre pa ambalazhim si dhe restorantet të cilat i kompostojnë mbeturinat e tyre nga ushqimet.

Ideja është që këto dyqane të jenë më konkurente me çmime më të lira të cilat do i bënin atraktive për konsumatorët. Poashtu konsumatorët me vetëdije më të lartë mjedisore do tu ofrohej mundësia që të i kryenin furnizimet në këto dyqane.

Komunat do të luaj rolin e sajë që të i promovoj këto biznese dhe përmes lehtësimeve fiskale të e lehtësojnë afarizmin e tyre. Disa nga masat të cilat do ti ndërmerr komuna janë:

- Studimi i mënyrës së futjes së stimujve fiskal dhe kostove dhe përfitimeve
- Futja e stimujve të përshtatshëm fiskal përfshi tarifat preferenciale;
- Analizë e zbatimit të prokurimit të gjelbër për këto subjekte;

#### **Shpërndarja e komposterëve për shtëpi rezidenciale dhe restorante „zero mbeturina“:**

Komuna do të shpërndaj falas apo me bashkë-financim komposterë individual për të reduktuar mbeturinat e hudhura në kontejnerët apo shportat që grumbullohen dhe transportohen nga operatori.

Tabela.23. Shpërndarja e komposterëve për shtëpi rezidenciale dhe restorante „zero mbeturina“:

| Nr. | Shpërndarja e Kompostereve individual                             | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
|-----|-------------------------------------------------------------------|------|------|------|------|------|
| 1   | Numri i komposterëve individual të shpërndarë për EF „zero waste“ | 20   | 20   | 30   | 70   | 70   |

#### Komuna e Istogut

|   |                                                                             |    |    |    |    |    |
|---|-----------------------------------------------------------------------------|----|----|----|----|----|
| 2 | Numri i komposterëve individual biznese „zero waste“ (72 biznese sherbehen) | 30 | 30 | 20 | 30 | 30 |
|---|-----------------------------------------------------------------------------|----|----|----|----|----|

#### Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për çështjet e minimizimit dhe reduktimit të gjenerimit të mbeturinave përmes fushatave informuese.

Komuna në mënyrë kontinue do të organizoj fushatë informuese për qytetarët bizneset dhe institucionet mbi rëndësinë e parandalimit dhe reduktimit të gjenerimit të mbeturinave si dhe këshillat për ta arritur këtë objektivë.

### 3.4 Objektivi 2: Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

Fokusi primar i këtij objekti ka të bëjë me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale si dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale me theks të veçantë në MND, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat komerciale.

Edhe pse gomat, produktet elektrike dhe elektronike, bateritë etj., nuk janë kompetencë komunale, megjithatë duke iu referuar kuadrit ligjorë dhe praktikave të jashtme, komuna do të organizoj skemën e grumbullimit të organizuar të këtyre mbeturinave në kuadër të skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Tabela në vijim jep kornizën strategjike për objektivin 3 së bashku me disa masa aktivitete të propozuara:

**Tabela 24: Korniza strategjike e Objektivit 2**

| Nr. | Masat / aktivitet / treguesi i performancës                                                                                                                          | Treguesi                                                                    | Vlera bazë | Caku |      |      |      |      |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------|------------|------|------|------|------|------|
|     |                                                                                                                                                                      |                                                                             | 2022       | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| 2.1 | Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave                                                                                                                | Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit është zbatuar                        | -          | 1    | 1    | 1    | 1    | 1    |
| 2.2 | Studim i fizibilitetit të ndarjes së mbeturinave në burim dhe riciklimit dhe modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale | Studimi i fizibilitetit është zbatuar                                       | -          | 1    | -    | -    | -    | -    |
| 2.3 | Zgjerimi i mbulimit me shërbim të ndarjes së mbeturinave në burim                                                                                                    | % EF me shërbim të ndarjes në burim                                         | 0%         | 5%   | 10%  | 20%  | 30%  | 40%  |
| 2.4 | Riciklimi i mbeturinave riciklueshme jo-degraduese                                                                                                                   | % e riciklimit të plastikës, letres, kartonit, qelqit dhe metalit.          | 0%         | 5%   | 10%  | 20%  | 30%  | 40%  |
| 2.5 | Riciklimi i mbeturinave bio-degraduese                                                                                                                               | % e riciklimit të mbeturinave ushqimore dhe mbeturinave tjera biodegraduese | 0%         | 5%   | 10%  | 20%  | 30%  | 40%  |
| 2.6 | Kontraktimi i operatorit të licencuar për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave të riciklueshme jo-degraduese                                    | Operatori është kontraktuar                                                 |            | 1    | 2    |      |      |      |
| 2.7 | Kontraktimi i operatorit të licencuar për grumbullimin                                                                                                               | Operatori është kontraktuar                                                 |            | 1    | 2    |      |      |      |

## Komuna e Istogut

|      |                                                                                                                |                                                                                         |   |   |  |
|------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|---|---|--|
|      | dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave bio degraduese                                                    |                                                                                         |   |   |  |
| 2.8  | Studimi i fizibilitetit për modelin e operimit të qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit                     | Studimi i fizibilitetit është zbatuar                                                   | 1 |   |  |
| 2.9  | Funksionalizimi i qendrës së grumbullimit dhe riciklimit                                                       | Qendra e grumbullimit është funksionalizuar dhe futur në operim                         |   | 1 |  |
| 2.10 | Caktimi i lokacionit të deponisë së MND                                                                        | Lokacioni i deponisë të MND është përcaktuar dhe procedurat administrative janë zbatuar | 1 |   |  |
| 2.11 | Studimi i fizibilitetit për modelin e operimit të grumbullimit, transportimit dhe riciklimit të MND në komune. | Studimi i fizibilitetit është zbatuar                                                   | 1 |   |  |
| 2.12 | Kontraktimi i operatorit të licencuar për MND                                                                  | Operatori është kontraktuar                                                             |   |   |  |

### Analiza e potencialit të gjenerimit, kompozicionit dhe riciklimit të mbeturinave në komunë

Parashikimet demografike në tabelën e mëposhtme janë marrë nga ASK dhe janë të ndara në zonën urbane dhe rurale.

| Tabela 25: Parashikimet demografike të popullatës |                    |      |      |      |      |      |
|---------------------------------------------------|--------------------|------|------|------|------|------|
| Vendbanimi                                        | Numri i popullatës |      |      |      |      |      |
|                                                   | 2022               | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| Qyteti (rritje / zbritje)                         | Ska të dhëna       |      |      |      |      |      |
| Qyteti (banorë)                                   | Ska të dhëna       |      |      |      |      |      |
| Zona rurale (rritje / zbritje)                    | Ska të dhëna       |      |      |      |      |      |
| Zona rurale (banorë)                              | Ska të dhëna       |      |      |      |      |      |
| Total banorë                                      | 40903              |      |      |      |      |      |

Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave dhe kompozicionit të tyre është dhënë në tabelat në vijim i bazuar në studimin e kompozicionit të mbeturinave nga Peja.

| Tabela 26: Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave |        |        |        |        |        |        |
|----------------------------------------------------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
|                                                    | 2022   | 2023   | 2024   | 2025   | 2026   | 2027   |
| Popullata                                          | 39,289 | 39,289 | 39,289 | 39,289 | 39,289 | 39,289 |

#### Komuna e Istogut

|                                |             |             |             |             |             |             |
|--------------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Gjenerimi për kokë banori      | 413 kg/vit  | 413 kg/vit  | 413 kg/vit  | 413 kg/vit  | 413 kg/vit  | 413 kg/vit  |
| Gjenerimi për kokë banori      | 1.1kg PCP   | 1.1kg PCP   | 1.1kg PCP   | 1.1kg PCP   | 1.1kg PCP   | 1.1kg PCP   |
| Gjenerimi vjetor i mbeturinave | 16,252t/vit | 16,252t/vit | 16,252t/vit | 16,252t/vit | 16,252t/vit | 16,252t/vit |

Në lidhje me kompozicionit/ përbërjes së mbeturinave nuk është bërë ndonjë analizë. Analiza e gjenerimit rrjedhimisht do të bazohet në bazë të matjes ndërsa popullata nuk parashihet të rritet për periudhën planifikuese. Sa i përket kompozicionit analiza bazohet në studimin e qytetit të Pejës.

Tabela 27. Kompozicioni i mbeturinave bazuar në analizën e kompozicionit të mbeturinave 2020-2021 (rasti Pejë).

Tabela 27: Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit

| Fraksioni                                        | 2023   | 2024   | 2025   | 2026   | 2027   |
|--------------------------------------------------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Letër dhe karton(+2%)                            | 19.15% | 19.53% | 19.92% | 20.32% | 20.70% |
| Qelq                                             | 6.45%  | 6.6%   | 6.7%   | 6.84%  | 6.90%  |
| Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat | 34.45% | 33.76% | 33.09% | 32.4%  | 31.77% |
| Tekstil dhe veshjet                              | 5.85%  | 5.73%  | 5.61%  | 5.5%   | 5.3%   |
| Pllastika                                        | 19.45% | 19.84% | 20.23% | 20.64% | 21%    |
| Metal                                            | 1.05%  | 1.03%  | 1%     | 0.98%  | 0.96%  |
| Të tjera                                         | 13.60% | 13.87% | 14.40% | 14.5%  | 14.7%  |
| Letër dhe karton                                 | 3 112  | 3 119  | 3 124  | 3 127  | 3 130  |
| Qelq                                             | 1 048  | 1 050  | 1 052  | 1 053  | 1 055  |
| Mbeturina bio-degraduese <sup>17</sup>           | 5 599  | 5 612  | 5 620  | 5 626  | 5 630  |
| Tekstil dhe veshjet                              | 951    | 952    | 954    | 956    | 956    |
| Pllastika                                        | 3 161  | 3 168  | 3 172  | 3 177  | 3 179  |
| Metal                                            | 171    | 171    | 171    | 172    | 172    |
| Të tjera                                         | 2 210  | 2 215  | 2 218  | 2 222  | 2 223  |

Në tabelën në vijim janë dhënë caqet preliminare të komunës karshi ripërdorimit / riciklimit të fraksioneve të caktuara të mbeturinave komunale si letra, plastika, qelqi, plastika dhe metali si dhe mbeturinat biodegraduese.

Megjithatë për caqe më të sakta të ripërdorimit dhe riciklimit komunat duhet që të zbatoj një studim të fizibilitetit të riciklimit të mbeturinave në komunë.

Në tabelën në vijim vendoset caqet preliminare të riciklimit në % dhe duke shumëzuar me gjenerimin e të riciklueshmeve fitohet sasia e planifikuar e riciklimit.

Tabela 228: Caqet e riciklimit

| Fraksioni                            | 2023 | 2024 | 2025  | 2026  | 2027  |
|--------------------------------------|------|------|-------|-------|-------|
| Të riciklueshmet jo-degraduese %     | 5%   | 10%  | 15%   | 20%   | 25%   |
| Të riciklueshmet jo-degraduese (ton) | 375  | 751  | 1 128 | 1 506 | 1 884 |

<sup>17</sup> Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat

## Komuna e Istogut

|                                      |     |     |     |       |       |
|--------------------------------------|-----|-----|-----|-------|-------|
| Të riciklueshmet biodegraduese %     | 5%  | 10% | 15% | 20%   | 25%   |
| Të riciklueshmet biodegraduese (ton) | 280 | 561 | 843 | 1 125 | 1 407 |

### Avancimi i sistemit të ndarjes, grumbullimit dhe riciklimit të mbeturinave komunale:

- Zgjerimi i shërbimit të ndarjes së mbeturinave në burim:

Komuna e Istogut është e përkushtuar që të bëjë ndarjen në burim të mbeturinave komunale si mënyrë për të zbutur presionin mjedisor nga deponimi eksziv si dhe zhvilluar ekonominë qarkore. Format e ndarjes varen nga faktorë të ndryshëm dhe mundë të marrin forma sa vijon:

- o Ndarja në dy fraksione „thatë dhe të lagësht“ me grumbullim derë më derë si dhe me kontejner të përbashkët
- o Ndarja në tre fraksione „recikluese jo-biodegraduese, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim derë më derë si dhe me kontejner të përbashkët
- o Ndarja në mbi tre fraksione „letër – qelq – plastikë - metal, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët

Forma e ndarjes kushtëzohet nga tipi i vendëbanimit (rezidencial dhe banim kolektiv), kapaciteti buxhetorë, infrastrukturës ricikluese, modelit të operimit e të ngjashme.

Megjithatë tipi i ndarjes së mbeturinave do të përcaktohet nga **studimi i fizibilitetit të ndarjes dhe riciklimit** që do ta zhvilloj komuna.

Në tabelën në vijim jepen caqet e ndarjes së mbeturinave në burim:

Tabela 29: Orari i ndarjes së mbeturinave në burim

|                            | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
|----------------------------|------|------|------|------|------|------|
| Mbulimi me shërbim (total) | 90%  | 95%  | 97%  | 100% | 100% | 100% |
| Mbulimi me ndarje në burim | 0%   | 5%   | 10%  | 20%  | 30%  | 40%  |

Commented [AN6]: 100% në vitin 2023

- Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave të riciklueshme jo të degradueshme:

Komuna e Istogut do të zbatojë një **studim të fizibilitetit të ndarjes dhe riciklimit si dhe të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale i cili përfshin si fraksion të ndarë mbeturinat e riciklueshme jo-biodegraduese**<sup>18</sup>. Studimi do të bazohet në analizën e kompozicionit, tregun e të riciklueshmeve dhe sektorin e ricikluesve privat dhe poashtu do të marrë parasysh kërkesat ligjore dhe politikat kombëtare të menaxhimit të mbeturinave si dhe praktikën më të mirë.

Sipas strategjisë së mbeturinave 2021 – 2030 parashihet të zbatohet skema e sistemit të kthimit të depozitës për ambalazhet e pijeve tek prodhuesit dhe tregëtarët e pijeve që paraqet një përqindje të konsiderueshme të këtyre mbeturinave. Poashtu strategjia e mbeturinave parasheh operimin e qendrave të riciklimit ku do të dërgohen këto mbeturina.

<sup>18</sup> Letra, plastika, metali, tekstili ,etj.

## Komuna e Istogut

Megjithatë deri sa të zbatohet skema e kthimit të depozitës dhe funksionalizohet qendra e riciklimit komuna do të synoj të bëjë partneritet me ricikluesit privat për të bërë grumbullimin dhe transportin e të riciklueshmeve jo-biodegraduese.

Pra komuna sa i përket mbeturinave të riciklueshme jobiodegradues do të zbatoj:

- studimin e fizibilitetit të zbatimit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave të riciklueshme të padegradueshme
- zhvillimi e partneritet me ricikluesit privat për grumbullimin dhe transportin e këtyre mbeturinave
- Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale biodegraduese:

Ngjashëm si me mbeturinat e riciklueshme jo të degradueshme, komuna do të zbatoj një **studim të fizibilitetit të ndarjes dhe riciklimit si dhe të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale i cili përfshion si fraksion të ndarë mbeturinat biodegraduese**. Mbeturinat që do të përfshihen në këtë fraksion do të jenë mbeturinat nga ushqimet, vajrat e përdorura ushqimore, dhe mbeturinat nga parqet, tregjet e gjelbërta dhe hapësirat publike.

Sipas strategjisë së mbeturinave secili rajon do të ketë një qendër të kompostimit të centralizuar ku do të dërgohen **mbeturinat biodegraduese ushqimore**. Por deri sa të ndërtohet dhe funksionalizohet kjo qendër komuna do të konsideroj zhvillimin e skemës lokale të kompostimit përmes angazhimit të operatorëve privat të interesuar që të grumbullojnë dhe transportojnë këto mbeturina.

Komuna do të ndërtoj skemën lokale të kompostimit për **mbeturinat biodegraduese nga parqet, tregjet e gjelbërta dhe hapësirat publike** të cilat për shkak të specifikave të tyre duhet të kompostohen lokalisht meqë transportimi i tyre është i kushtueshëm dhe joefikas.

Sa i përket **vajrave të përdorura ushqimore** komuna do të u kërkoj objekteve gastronomike që i prodhojnë këto vajëra me shumicë të lidhin kontrata valide me operatorët të licencuar të vajërave ushqimore nga MESPI të cilët do të bëjnë grumbullimin e organizuar të këtyre vajrave. Komuna do të organizoj mbikëqyrjen dhe inspektimin e mbarëvajtjes së kësaj skeme të organizimit dhe do të shqiptoj dënime në rast të shkeljeve.

Pra komuna sa i përket mbeturinave biodegraduese do të zbatoj:

- studimin e zbatimit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave komunale biodegraduese
- zhvillimin e skemës lokale të kompostimit në partneritet me ricikluesit privat
- inspektimin e lokaleve gastronomike sa i përket zbatimit të kontratës për vajra mbeturinë

**Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale:**

- Hapia e qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit:

Komuna e Istogut planifikon të hap **qendrën e grumbullimit dhe ripërdorimit të mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale**. Për hapjen e kësaj qendre komuna do ta caktoj lokacionin.

Në këtë objekt qytetarët do të dërgojnë artikujt e padëshiruar të tyre sa vijon:

- Mobilje dhe orendi
- Tekstil dhe veshëmbathje
- Pajisje shtëpiake dhe mbeturina tjera të vëllimshme

Përpos këtyre artikujve të padëshiruar qytetarët mund të dorëzojnë edhe gomat, bateritë, vajrat mbeturinë dhe mbeturina tjera.

Komuna do të zbatoj një **studim të fizibilitetit të modelit të operimit** të qendrës përmes së cilit do të analizohet dhe do të vendoset se a do ta menaxhoj vetë këtë qendër komuna apo ta angazhoj një operator privat.

**Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi:**

Sa i përket MND ligji parasheh caktimin e lokacionit të deponisë që është një zgjidhje e përkohshme dhe ndërtimin dhe funksionalizimin e qendrës së grumbullimit dhe riciklimit të këtyre mbeturinave e cila sipas strategjisë së mbeturinave do të organizohet në formë rajonale.

Komuna sipas ligjit e kontraktos shërbimin me operator të licencuar, cakton tarifat e shërbimit dhe se ndërtuesit kanë të drejtë që të ndajnë dhe riciklojnë mbeturinat e tyre në kantierin e punimit si dhe të transportojnë mbeturinat deri te destinacioni i autorizuar.

Komuna nuk e ka caktuar lokacionin e përkohshëm të deponisë, por në fakt i dërgon në një lokacion të përkohshëm i cili do të mbyllet deri në vitin 2025. Komuna do të dërgoj mbeturinat në këtë lokacion deri në afatin e mbylljes. Komuna megjithatë do të ndërmerr hapat që ta përcaktoj lokacionin siq kërkohet me ligj për këtë parcellë. Me pastaj mbeturinat do të dërgohen në Deponin Regjionale në Pejë.

Komuna do të instaloj një sistem i cili në kuadër të lejes ndërtimore do të kërkoj që ndërtuesi të ketë edhe një plan të menaxhimit të mbeturinave ku parashihet sasia e mbeturinave që do të deponohen dhe lokacioni ku do të dërgohen ato. Poashtu inspeksioni do të mbikëqyrë zbatimin e këtij plani dhe të parandaloj hudhje e këtyre mbeturinave në vendë të papërshtatshme.

Poashtu tarifat do të caktohen në nivel të komunave të cilat do të shërbejnë nga kjo qendër e grumbullimit dhe riciklimit të MND.

Komuna për territorin e saj do të zbatoj një studim fizibiliteti të modelit të operimit të grumbullimit dhe transportit të MND si dhe të riciklimit të tyre nga ndërtuesit dhe do të ndërmarr disa investime në deponinë ndërtimore që ta kthejë në qendër të ripërdorimit dhe riciklimit të materialeve.

## Komuna e Istogut

### **Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave nga kujdesi shëndetësor:**

Komuna, respektivisht Drejtorati për Shëndetësi, por edhe Drejtorati i Inspeksionit, do të monitoroj menaxhimin e mbeturinave spitalore sipas legjislacionit në fuqi.

Inspektori komunal i mjedisit do të bëjë mbikqyrje inspektive mbi menaxhimin e mbeturinave edhe atyre medicinale në këtë rast, bazuar në Nenin 62, 63, 65, dhe 66 të Ligjit për Mbeturina.

Komuna - Drejtoria pergjegjese për shëndetësi do të siguroj dhe vendos kontejnerë për hedhjen e barnave te përdorura dhe me afat të skaduar direkt nga qytetarët.

Prodhuesit e mbeturinave medicinale publik dhe privat gjatë aktivitetit të tyre të kujdesit shëndetësorë, do të hudhin mbeturinat e tyre në mënyrë të klasifikuar mbeturinat sipas llojeve në kontejnerë, enë apo thasë përkatës të siguruar nga vetë ata, deri sa të grumbullohen nga operatori i licencuar që i përpunon dhe i menaxhon ato. Inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të siguroj zbatimin e këtij obligimi ligjor.

Operatorët publik dhe privat si prodhues të mëdhenj të mbeturinave medicinale të rrezikshme do të hartojnë planin për menaxhimin e mbeturinave medicinale dhe ekzistenca e këtij plani dhe zbatimi i tij do të kontrollohen nga inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë.

Nëse institucionet shëndetësore nuk i trajtojnë vet mbeturinat spitalore që i krijojnë, atëherë duhet të kenë kontratë me operatorët e licencuar për trajtimin e këtyre mbeturinave. Inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të kontrollojë nëse këto kontrata janë të lidhura dhe po zbatohen.

### **Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave shtazore nga thertoret:**

Sipas strategjisë së mbeturinave, mbeturinat shtazore nga thertoret do të dërgohen tek qendra e grumbullimit dhe riciklimit në zonën industriale në Drenas të ndërtuar nga BE. Megjithatë kjo qendër ende nuk po funksionalizohet që po na e pamundëson organizimin e kësaj skeme.

Komuna do të organizoj këtë shërbim për fazën tranzitore deri në funksionalizim të qendrës duke i dërguar këto mbeturina nga operatori i grumbullimit të mbeturinave për të bërë varrimin e tyre të gëlqelosur dhe njëkohësisht të shikoj mundësin e angazhimit të operatorëve privat të licencuar nga AVUK që të bëjnë grumbullimin e organizuar të këtyre mbeturinave tek impijantet e tyre.

Mishtoret, therrëtoreset dhe industritë përpunuese të mishit duhet të sigurojnë kontejnerë hermetik të ndarë ku do të hudhin mbeturinat shtazore deri në momentin e grumbullimit dhe të kenë kontrata valide me operatorin të cilat do të inspektohen nga komuna në mënyrë periodike.

#### Komuna e Istogut

##### **Aktivitet vetëdijësuese për ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave:**

Komuna do të organizoj fushata informative të komunikimit me publikun sa i përket ndarjes, ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave komunale, dhe kategorive tjera.

Informimi do të sqaroj se si duhet të hudhen mbeturinat në kontejnerë / shporta të ndara, për dërgimin e mbeturinave në qendrën e grumbullimit dhe ripërdorimit, dhe të ngashme. Fushata do të organizohet që të targetoj institucionet shkollore për të ngritur nivelin e edukimit mjedisorë.

### 3.5 Objektivi nr. 3: Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme të MM

Objektivi 3 ka të bëjë me komponentën e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale. Ky objektivi synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve me theks të aspekteve të qëndrueshmërisë financiare dhe të kostos.

Tabela 30: Korniza strategjike e objektivit 3

| Nr. | Aktiviteti / masa                                                                                                  | Treguesi                                                                                      | Vlera bazë |      | Caku |      |      |      |  |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------|------------|------|------|------|------|------|--|
|     |                                                                                                                    |                                                                                               | 2022       | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |  |
| 3.1 | Mbulimi me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale                                         | % e popullatës së shërbyer me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale | 90%        | 95%  | 97%  | 100% | 100% | 100% |  |
| 3.2 | Plani i ri operativ për shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale është hartuar dhe miratuar | Plani operativ është hartuar / reviduar dhe miratuar                                          | -          | 1    |      |      |      |      |  |
| 3.3 | Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave                                            | Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave është zbatuar         | -          | -    | 1    | -    | -    | -    |  |
| 3.4 | Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave                   | Komuna ka marrë përsipër faturimin dhe arkëtimin                                              | -          | -    | 1    | -    | -    | -    |  |
| 3.5 | Zgjidhja e statusit të rasteve sociale                                                                             | Pagesa e faturave për rastet sociale është zgjidhur                                           | -          | -    | 1    | -    | -    | -    |  |
| 3.6 | Numri i ankesave të qytetarëve në shërbim të mbeturinave                                                           | Numri i ankesave të qytetarëve në shërbim të mbeturinave                                      | 20         | 15   | 15   | 10   | 10   | 5    |  |

Në vijim jepen masat dhe aktivitetet kyçe të objektivës 3:

#### Zgjerimi i mbulimit me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Tabelat në vijim jep orarin e zgjerimit të shërbimit dhe të dhënat e popullatës janë marrë nga ASK. Komuna është e përkushtuar që të zgjerojë ofrimin e shërbimit në tërë territorin e saj. Strategjia e zgjerimit është që fillimisht të ofrohet shërbim i plotë në zonën urbane si dhe mbulimi me shërbim edhe për zonën rurale.

Tabela 31: Strategjia e zgjerimit me shërbim

#### Komuna e Istogut

|                    | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
|--------------------|------|------|------|------|------|------|
| Mbulimi me shërbim | 90%  | 95%  | 97%  | 100% | 100% | 100% |

#### Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

##### Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale:

Komuna do të bëjë **planin e ri operativ** për riorganizimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave i cili do të rezultoj në përmirësimin e cilësisë së shërbimit përmes:

- Optimizimit të pikave të grumbullimit dhe frekuencës së ofrimit të shërbimit;
- Sigurimin e infrastrukturës adekuate për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale

Komuna do të **digjitalizoj sistemin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave** i cili do të përmirësoj cilësinë dhe efikasitetin e shërbimit. Ky sistem do të ofroj informacionet për lëvizjet e kamionëve, informatat mbi lokacionin e kontejnerëve, nivelin e mbushjes dhe informatave tjera relevante si dhe i njëjti do të integrohet me databazën e kujdesit të konsumatorëve.

Komuna do të ndërmer **kampanjë informative** për ti informuar qytetarët për mënyrën e re të grumbullimit të mbeturinave përfshi mënyrën e hudhjes së mbeturinave, frekuencën e shërbimit e të ngjashme.

#### Përmirësimi i efikasitetit operativ dhe të koston

Komuna ka përcaktuar si objektiv përmirësimin e efikasitetit operativ dhe të koston në funksion të përmirësimit të qendrueshmëris financiare. Shtyllat kryesore të këtij plani janë optimizimi i efikasitetit të stafit dhe harxhimit të naftës.

##### Përmirësimi i efikasitetit të stafit

Komuna do të zbatoj aktivitetet sa vijon për ta përmirësuar efikasitetin e stafit të ofruesve publik të shërbimeve:

- Kontrollin (ngrirjen) e regrutimit të stafit të ri administrativ dhe trajnimit të stafit ekzistues
- Zgjerimin e zonës së shërbimeve
- Diversifikimin dhe zgjerimin e shërbimeve
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së efikasitetit të stafit

Zyrtarët e MM dhe personat tjerë të përfshirë në planifikim, monitorim dhe mbikëqyrje të menaxhimit të mbeturinave duhet të mbajnë një kontroll strikt të numrit të stafit sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 32: Efikasiteti i stafit

## Komuna e Istogut

|                                                  | 2022   | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
|--------------------------------------------------|--------|------|------|------|------|------|
| Stafi direkt                                     | 23     | -    | -    | -    | -    | -    |
| Stafi indirekt dhe administrativ                 | 14     | -    | -    | -    | -    | -    |
| Amvisëritë (EF) e shërbyera                      | 6741   | -    | -    | -    | -    | -    |
| Efikasiteti i stafit për konsumatorë të shërbyer | 155.51 | -    | -    | -    | -    | -    |

### Përmirësimi i efikasitetit kostos së grumbullimit dhe të harxhimit të naftës

Harxhimi i naftës është njëri ndër zërat më të lartë të kostove rrjedhëse të operatorëve të shërbimit rreth 15% të kostove rrjedhëse në nivel të sektorit dhe kjo i atribuohet në masë të konsiderueshme joefikasitetit operativ por edhe keqmenaxhimit.

Masat / aktivitetet e propozuara përfshijnë:

- **Hartimi i planit të ri operativ** (riorganizmin e zonës dhe optimizimin e marshutave dhe frekuencës së grumbullimit)
- Zëvendësimi i kamionëve të vjetër me kamionë të rinjë apo funksional (second-hand)
- Ndërtimin e transfer stacionit për të shkurtuar distancën
- Përforsimin e kontrollit të brendshëm
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së harxhimit të naftës
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së kostos njësi të grumbullimit dhe transportit

### **Përmirësim i performancës financiare të ofrimit të shërbimit**

Komuna ka përcaktuar si objektiv përmirësimin e qëndrueshmëris financiare të ofrimit të shërbimeve. Masat kryesore të përmirësimit të qëndrueshmëris financiare janë:

- Kalimi i tarifave për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave mbi principet e mbulimit të kostos
- Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna
- Zgjidhja e pagesës së faturave për rastet sociale

Komuna e Istogut

3.6 Objektivi nr. 4: Trajtimi dhe deponimi i sigurt i mbeturinave si mjeti i fundit

Tabela 33: Korniza strategjike e objektivit 4

| Nr. | Aktiviteti / masa                                            | Treguesi                                   | Vlera bazë |      |      | Caku |      |      |
|-----|--------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|------------|------|------|------|------|------|
|     |                                                              |                                            | 2022       | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| 4.1 | Rehabilitimi i deponisë për të përmbush standardet mjedisore | Deponia është rehabilituar                 | -          | -    | 1    | -    | -    | -    |
| 4.2 | Kalimi i tarifave të deponimit                               | Tarifat e reja janë kalkuluar dhe miratuar | -          | -    | -    | 1    | -    | -    |

Rehabilitimi i deponive për të arritur standardet mjedisore

Rishikimi tarifor për të siguruar mekanizëm të qendrueshëm të financimit

## 3.7 Objektivi 5: Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave

Tabela 34: Korniza strategjike e objektivit 5

| Nr. | Aktiviteti / Masa                                                                        | Treguesi                                          | Vlera bazë |      |      | Caku |      |      |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|------------|------|------|------|------|------|
|     |                                                                                          |                                                   | 2022       | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| 5.1 | Revidimi i RrK të MM                                                                     | RrK e MM është reviduar                           | -          | -    | 1    | -    | -    | -    |
| 5.2 | Emërimi i zyrtarit / Formimi i njësitit                                                  | Zyrtari i MM është emëruar/Spektori është formuar | 1          | -    | -    | -    | -    | -    |
| 5.3 | Kalimi i procesit tariforë                                                               | Tarifat e reja janë kalkuluar dhe miratuar        | -          | -    | 1    | -    | -    | -    |
| 5.4 | Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale            | Operatori i licencuar është kontraktuar           | -          | -    | 1    | -    | -    | -    |
| 5.4 | Programi i trajnimit dhe mbështetjes së proceseve për komunën dhe operatorët po zbatohet | Operatori i licencuar është kontraktuar           | -          | -    | 1    | -    | -    | -    |

**Emërimi i zyrtarëve komunal apo themelimi i njësitit për MM**

Komuna e ka zbatuar këtë obligim në vitin 2020 me emërimin e zyrtarit komunal të MM.

**Emërimi i inspektorit mjedisorë**

Komuna e ka zbatuar këtë obligim në vitin 2020 me emërimin e inspektorit mjedisorë të MM.

**Kalimi i procesit tariforë**

Komuna e ka kaluar procesin tariforë në vitin 2019 dhe planifikon që ti nënshtrohet të njëjtit gjatë vitit 2024 për të reflektuar ndryshimin e kostove dhe parametrevë tjerë relevant.

**Zbatimi i programit të trajnimit dhe mbështetjes së proceseve për komunën dhe operatorët**

Ky program do të dizajnohet që të i ngris kapacitetet në zbatimin e proceseve si revidimi dhe zbatimi i PKMM, amendimi i RrK të MM, kalimin e procesit tariforë, draftimin dhe monitorimin e kontratave të shërbimit dhe partneriteti publiko privat, zbatimin e skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe skemës së kthimit të depozitës, ekonominë qarkore, riciklimin e mbeturinave e të ngjashme.

#### **4 Plani i MM në kushte emergjente**

Komunat duhet të bëjnë planifikimin e MM në kushte emergjente sipas kërkesave të Ligjit nr. 04/l-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, planit kombëtar të reagimit emergjent të Agjencisë për menaxhimin emergjent dhe ndonjë dokumenti tjetër relevant.

Fatkeqësitë sipas ligjit konsiderohen ngjarjet të shkaktuara nga forcat madhore të natyrës apo forcat tjera të pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave. Në fatkeqësi përfshihen: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, zjarret, shpërthim i sëmundjeve infektive aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, aksidentet ekologjike dhe industriale, lufta dhe gjendja emergjente, etj.

Ngjarja e fundit që ka kualifikuar për emergjencë apo fatkeqësi ka qenë pandemia Covid 19 dhe e cila na ka ofruar disa përvoja të dobishme.

Komuna do ta amendoj planin komunal të reagimit emergjent duke shtuar kaptinën për menaxhimin e shërbimit të mbeturinave në kushte emergjente!

## 5 Plani financiar, veprimet dhe monitorimi

Në tabelën në vijim janë paraqitur projektet kapitale që do mbështesin realizimin e objektivave të planit të financuar përmes buxhetit të komunës, bashkëfinancimit me komunitet tjetër apo me qeverinë si dhe projektet e financuara nga burimet e jashtme si qeveria donatorët, apo kapitali privat.

Tabela 38: Plani financiar, veprimet dhe monitorimi - Objektivi 1 „Parandalimi dhe reduktimi“

| Masat dhe aktivitetet                                                          | Njësi<br>përgjegjëse | 2023            | Afati i implementimit dhe buxheti | 2026            | 2027            | 2023 - 2027      | Burimi i financimit |
|--------------------------------------------------------------------------------|----------------------|-----------------|-----------------------------------|-----------------|-----------------|------------------|---------------------|
| Riorganizimi i shërbimit                                                       |                      |                 |                                   | 60,000 €        |                 | 60,000 €         |                     |
| o Plani i riorganizimit të shërbimit:                                          | DSHP                 |                 |                                   | 10,000 €        |                 | 10,000 €         | Komuna              |
| o Sigurimi i infrastrukturës matëse                                            | DSHP                 |                 |                                   | 50,000 €        |                 | 50,000 €         | Donacion            |
| Zbatimi i tarifave volumetrike                                                 |                      |                 | 10,000 €                          |                 |                 | 10,000 €         |                     |
| o Kalimi i tarifave PAYT (procesi)                                             | DSHP                 |                 | 2,500 €                           |                 |                 | 2,500 €          | Komuna              |
| o Azhurnimi i softuerit të faturimit                                           | DSHP                 |                 | 7,500 €                           |                 |                 | 7,500 €          | Komuna              |
| o Zbatimi i tarifave PAYT                                                      | KRM                  |                 |                                   | x               |                 |                  | KRM                 |
| Nxjerrja e pakos stimuluese për bizneset                                       |                      |                 |                                   | 2,500 €         |                 | 2,500 €          |                     |
| o Studimi i mënyrës së futjes së stimujve fiskal                               | DSHP                 |                 |                                   | 2,500 €         |                 | 2,500 €          | Komuna              |
| o Pakoja e lehtësimeve fiskale                                                 | DSHP                 |                 |                                   | x               |                 |                  | Komuna              |
| Shpërndarja e kompostereve për EF dhe restorante <sup>19</sup>                 | DSHP                 | 14,400 €        | 14,400 €                          | 14,400 €        | 14,400 €        | 72,000 €         | Donacion            |
| Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e minimizimit                            |                      | 700 €           | 700 €                             | 700 €           | 700 €           | 3,500 €          | Komuna              |
| o Fushata e vetëdijësimit                                                      | DSHP                 | 700 €           | 700 €                             | 700 €           | 700 €           | 3,500 €          | Komuna              |
| <b>Total objektiva 1 - Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave</b> |                      | <b>18,100 €</b> | <b>28,100 €</b>                   | <b>76,900 €</b> | <b>18,100 €</b> | <b>159,030 €</b> |                     |

Tabela 39: Plani financiar, veprimet dhe monitorimi - Objektivi 2 „Ripërdorimi dhe riciklimi“

| Masat dhe aktivitetet | Njësi | Afati i implementimit dhe buxheti | 2023 - | Burimi i |
|-----------------------|-------|-----------------------------------|--------|----------|
|-----------------------|-------|-----------------------------------|--------|----------|

<sup>19</sup> Furnizimi me komposterë: Vitet 2023 – 2027 nga 120 komposterë për vit;

Komuna e Istogut

|                                                                   | përgjegjës | 2023     | 2024     | 2025      | 2026    | 2027    | 2027      | financimit        |
|-------------------------------------------------------------------|------------|----------|----------|-----------|---------|---------|-----------|-------------------|
| Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave             | DSHP       |          | 5,000 €  |           |         |         | 5,000 €   | Komuna            |
| Ndarja dhe riciklimi i mbeturinave komunale                       |            | 5,000 €  | 5,000 €  | 110,000 € | 5,000 € | 5,000 € | 130,000 € | Komuna            |
| o Studim i fizibilitetit të ndarjes dhe operimit                  | DSHP       |          |          | 25,000 €  |         |         | 25,000 €  | Komuna            |
| o Zgjerimi i mbulimit të ndarjes në burim                         | DSHP       | 5,000 €  | 5,000 €  | 5,000 €   | 5,000 € | 5,000 € | 25,000 €  | Komuna            |
| o Kontraktimi i operatorit të riciklueshmeve                      | DSHP       |          |          | 5,000 €   |         |         | 5,000 €   | Komuna            |
| o Zhvillimi i skemës lokale të kompostimit                        | DSHP       |          |          | 75,000 €  |         |         | 75,000 €  | Donatori          |
| o Inspektimi i lokaleve gastronomike për vajëra                   | DSHP       | x        | x        | x         | x       | x       |           |                   |
| o Bashkimi i skemës ndërkomunal të kompostimit                    | DSHP       |          |          |           |         |         |           | Komuna            |
| Ndërtimi i transfer stacionit dhe qendrës ricikluese              | DSHP       | 15,000 € | 30,000 € | 70,000 €  |         |         | 100,000 € | Komuna            |
| Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale              |            | 15,000 € | 75,000 € |           |         |         | 90,000 €  | Komuna            |
| o Studimi i fizibilitetit                                         | DSHP       |          |          |           |         |         | 15,000 €  | Komuna            |
| o Ndërtimi i qendrës së grumbullimit / ripërdorimit <sup>20</sup> | DSHP       |          | 75,000 € |           |         |         | 75,000 €  | Komuna / donatori |
| o Funkcionalizimi i qendrave                                      | DSHP       |          |          | x         |         |         |           | Komuna            |
| Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi                      |            |          | 28,000 € | 150,000 € |         |         | 178,000 € |                   |
| o Caktimi i lokacionit                                            | DSHP       |          |          |           |         |         |           |                   |
| o Kontraktimi i operatorit                                        | DSHP       |          | 5,000 €  |           |         |         | 5,000 €   | Komuna            |
| o Caktimi i tarifave                                              | DSHP       |          | 3,000 €  |           |         |         | 3,000 €   | Komuna            |
| o Studimi i fizibilitetit                                         | DSHP       |          | 20,000 € |           |         |         | 20,000    | Komuna / donatori |
| o Rehabilitimi i qendrës së MND <sup>21</sup>                     | DSHP       |          |          | 150,000 € |         |         | 150,000 € | Komuna            |
| Menaxhimi i skemës ndërkomunale të menaxhimit                     | DSHP       |          |          |           |         | x       |           | Komuna            |
| Menaxhimi i mbeturinave shtazore                                  |            |          |          |           |         |         |           |                   |
| o Lehtësimi i kontraktimit të operatorit privat                   |            | x        | x        |           |         |         |           |                   |
| o Inspektimi i zbatimit                                           |            | x        | x        | x         | x       | x       |           |                   |
| Menaxhimi i mbeturinave medicinale                                |            |          |          |           |         |         |           |                   |
| o Inspektimi i zbatimit                                           |            | x        | x        | x         | x       | x       |           |                   |
| Fushatat e vetëdijësimit                                          |            | 700 €    | 700 €    | 700 €     | 700 €   | 700 €   | 3,500 €   | Komuna            |

<sup>20</sup> Për komunën e Istogut parashihet ndërtimi i një qendre të ripërdorimit. Buxheti përfshin infrastrukturën përcjellëse të qendrës si rrethoja, kamerat, bazamenti, kontejnerët, etj.

<sup>21</sup> Fizibiliteti, rrethoja, makineria dhe pajisjet e nevojshme për menaxhimin e qendrës

Komuna e Istogut

| Total objektiva 2 – Riciklimi dhe ripërdorimi                                                                                |                   | 20,700 € | 163,700 €                         | 330,700 €   | 5,700 €   | 5,700 €   | 406,500 €           |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|----------|-----------------------------------|-------------|-----------|-----------|---------------------|
| Tabela 40: Plani financiar, veprimet dhe monitorimi - Objektivi 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme“ |                   |          |                                   |             |           |           |                     |
| Masat dhe aktivitetet                                                                                                        | Njësi përgjegjëse | 2023     | Afati i implementimit dhe buxheti |             | 2026      | 2027      | Burimi i financimit |
| Përmirësimi i cilësisë së shërbimit                                                                                          |                   | 86,000 € | 2024                              | 2025        | 2026      | 2027      |                     |
| o Hartimi i planit operativ                                                                                                  | DSHP/KRM          | 25,000 € | 191,000 €                         | 1,156,000 € | 856,000 € | 281,000 € | Komuna              |
| o Digitalizimi i sistemit të grumbullimit                                                                                    | DSHP/KRM          |          |                                   | 100,000 €   |           |           | Komuna              |
| o Furnizimi me shporta 120 l <sup>22</sup>                                                                                   | DSHP/KRM          | 10,000 € | 40,000 €                          | 40,000 €    | 40,000 €  | 30,000 €  | Donatori            |
| o Furnizimi me shporta 240 l <sup>23</sup>                                                                                   | DSHP/KRM          | 6,000 €  | 6,000 €                           | 6,000 €     | 6,000 €   | 6,000 €   | Donatori            |
| o Furnizimi me kontejnerë 1.1 m <sup>3</sup> <sup>24</sup>                                                                   | DSHP/KRM          | 45,000 € | 45,000 €                          | 45,000 €    | 45,000 €  | 45,000 €  | Donatori            |
| o Furnizimi me katër kamionë 5-7 ton                                                                                         | DSHP/KRM          |          | 100,000 €                         | 100,000 €   | 100,000 € | 100,000 € | Donatori KRM        |
| o Furnizimi me një kamionë 12 ton                                                                                            | DSHP/KRM          |          | 150,000 €                         |             |           |           | Donatori            |
| o Furnizimi me dy kamionë transferi                                                                                          | DSHP/KRM          |          | 300,000 €                         | 300,000 €   | 300,000 € |           | Donatori            |
| o Furnizim me traktorë                                                                                                       | DSHP/KRM          |          | 25,000 €                          | 20,000 €    | 20,000 €  |           | KRM Donatori        |
| o Furnizimi me kamionë me grepa                                                                                              | DSHP/KRM          |          | 120,000 €                         |             |           |           | Donatori            |
| o Furnizimi me kamion kiper                                                                                                  | DSHP/KRM          |          |                                   |             | 100,000 € | 100,000 € | Donatori            |
| o Furnizimi me autocisternë                                                                                                  | DSHP/KRM          |          |                                   |             |           | 100,000 € | Donatori            |
| o Rregullimi i autoparkut                                                                                                    | DSHP/KRM          |          | 150,000 €                         |             |           |           | Donatori            |
| o Ndërtimi objektit administrativ                                                                                            | DSHP/KRM          |          |                                   |             | 200,000 € |           | Donatori            |
| o Furnizimi me eskavator                                                                                                     | DSHP/KRM          |          |                                   | 100,000 €   |           |           | KRM / Donatori      |
| o Furnizimi me kamionetë                                                                                                     | DSHP/KRM          |          |                                   | 10,000 €    |           |           | KRM                 |
| o Furnizimi me 3 autofshesa                                                                                                  | DSHP/KRM          |          |                                   |             | 45,000 €  |           | Donatori            |
| o Furnizimi me pickup                                                                                                        | DSHP/KRM          |          |                                   | 10,000 €    |           |           | KRM                 |
| Përmirësimi i performancës op dhe financiare                                                                                 |                   | 750 €    | 20,750 €                          | 750 €       | 750 €     | 750 €     |                     |
| o Marrja e faturimit nga komuna                                                                                              | DSHP/KRM          |          |                                   | x           |           |           | Komuna              |
| o Zhvillimi i softuerit të faturimi <sup>25</sup>                                                                            | DSHP/KRM          |          | 20,000 €                          |             |           |           | Komuna              |

<sup>22</sup> Furnizimi me shporta 120 l sipas viteve: Viti 2023 500 shporta; viti 2024 - 2026 nga 2,000 shporta; dhe 2027 nga 1,500 shporta.

<sup>23</sup> Furnizimi me shporta 240 l: Vitet 2023 – 2027 nga 200 shporta.

<sup>24</sup> Furnizimi me kontejnerë 1.1m<sup>3</sup>: Viti 2023 50 kontejnerë; vitet 2024, 2025 2026 dhe 2027 nga 30 kontejnerë.

Komuna e Istogut

| O | Monitorimi i performancës                                                     | DSHP/KRM | X               | X                | X                  | X                | X                | X                  | X     | Komuna |
|---|-------------------------------------------------------------------------------|----------|-----------------|------------------|--------------------|------------------|------------------|--------------------|-------|--------|
|   | Kampanja informative                                                          | OJU      | 750 €           | 750 €            | 750 €              | 750 €            | 750 €            | 750 €              | 750 € | Komuna |
|   | <b>Total objekti 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore efikase dhe qëndrueshme“</b> |          | <b>86,750 €</b> | <b>211,750 €</b> | <b>1,156,750 €</b> | <b>856,750 €</b> | <b>281,750 €</b> | <b>2,593,500 €</b> |       |        |

Tabela 38: Plan i financiar, veprimet dhe monitorimi - Objekti 4 „Deponimi i sigurtë si mjete i fundit“

| Masat dhe aktivitetet                                         | Njësi përgjegjëse | 2023            | Afati i implementimit dhe buxheti | 2025            | 2026            | 2027            | 2023 - 2027      | Burimi i financimit |
|---------------------------------------------------------------|-------------------|-----------------|-----------------------------------|-----------------|-----------------|-----------------|------------------|---------------------|
| Rehabilitimi i deponisë                                       | DSHP              | 25,000          | 25,000 €                          |                 |                 |                 | 25,000 €         | Komuna              |
| Caktimi i tarifave të shërbimit të depozimit                  | DSHP              |                 |                                   | X               |                 |                 |                  | Komuna              |
| Eliminimi i deponive ilegale                                  | DSHP              | 30,000 €        | 25,000 €                          | 22,500 €        | 22,500 €        | 20,000 €        | 120,000 €        | Komuna              |
| Inspektimi dhe masat detyruese                                | Inspektorati      |                 |                                   |                 |                 |                 |                  | Komuna              |
| <b>Total objekti 4 – Deponimi i sigurtë si mjete i fundit</b> |                   | <b>30,000 €</b> | <b>50,000 €</b>                   | <b>22,500 €</b> | <b>22,500 €</b> | <b>20,000 €</b> | <b>145,000 €</b> |                     |

**Commented [AN7]:** Në Tugës duhet të rehabilitohet në vitin 2023

Tabela 39: Plan i financiar, veprimet dhe monitorimi - Objekti 5 „Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM“

| Masat dhe aktivitetet                                                        | Njësi përgjegjëse | 2023           | Afati i implementimit dhe buxheti | 2025           | 2026           | 2027 | 2023 - 2027     | Burimi i financimit |
|------------------------------------------------------------------------------|-------------------|----------------|-----------------------------------|----------------|----------------|------|-----------------|---------------------|
| Revidimi i RrK të MM                                                         | DSHP              |                |                                   | 5,000 €        |                |      | 5,000 €         | Komuna              |
| Emërimi i zyrtarit / Formimi i njësitit                                      | DSHP              | X              |                                   |                |                |      |                 | Komuna              |
| Kalimi i procesit tariforë                                                   | DSHP              |                | 3,500 €                           |                |                |      | 3,500 €         | Komuna              |
| Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të MK                  | DSHP              |                | 5,000 €                           |                |                |      | 5,000 €         | Komuna              |
| Programi i trajnimit dhe mbështetjes së proceseve                            | DSHP              | 5,000 €        | 5,000 €                           | 5,000 €        | 5,000 €        |      | 20,000 €        | Komuna              |
| Hartimi i Planit të Emergjencës                                              |                   |                | 3,000 €                           |                |                |      | 3,000 €         | Komuna              |
| <b>Total objekti 5 – Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale</b> |                   | <b>5,000 €</b> | <b>21,500 €</b>                   | <b>5,000 €</b> | <b>5,000 €</b> |      | <b>36,500 €</b> |                     |

**Commented [AN8]:** Brenda këtij viti emrohet sepse është hapur konkursi

Kryesues i Kuvendit

Z. Enver Rugova

